

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5792
E shtunë, 1 qershor 2019
çmimi 0.40 €

MPJ-ja kërkon nga
qytetarët që përkohësisht
ta evitojnë qarkullimin
përmes Serbisë | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", BASHKIM RAMOSAJ | FAQE 4-5

Është e padrejtë kërkesa që t'ia japim 24 hektarë tokë Manastirit të Deçanit



Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, e ka quajtur "vetëvrasje" për këtë komunë zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për t'ia dhënë 24 hektarë tokë Manastirit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka

thënë se është i padrejtë ky vendim sepse e ngulfat zhvillimin ekonomik të Komunës së Deçanit. Ramosaj ka shprehur gatishmërinë për gjetjen e një zgjidhje në mes të komunës dhe Manastirit pa iu nënshtruar vendimit të Kushtetueses. Sipas tij, është e

drejtë natyrore e popullit t'i shfrytëzojë potencialet dhe resurset që Zoti ia ka dhënë Deçanit. Ai u ka bërë thirrje institucioneve vendore dhe ndërkombëtare që të angazhohen për një zgjidhje të përbashkët e cila do t'i kënaqte të dyja palët

OPINION

**CIVILIZIMI QË
ERDHI NGA
MALET** F.12

Shkruan:
Blerim LATIFI



AKTUALE

**AMBULANCAT E REJA
SPECIALISTIKE PËR KATËR
MUAJ OFRUAN 51 MIJË
SHËRBIME PËR PACIENTËT** F. 7

**VAJZA E XHEMAJL
FETAHAJT: BABAI IM NUK I
KA TAKUAR ASNJË KRAHU,
POR VETËM UÇK-së** F. 6



EKONOMI

**TELEKOMI I KOSOVËS,
KONTRATË TË RE
KOLEKTIVE** F. 8

**A KA NDIKUAR TAKSA NË
RRITJEN E KONTRABANDËS
NË PJESËN VERIORE TË
KOSOVËS?** F. 9

KULTURË

**PËRURORHET SHTËPIA MUZE E
KATARINA JOSIPIT** F. 7

SPORT

**MKRS-JA MBËSHTET
FUQISHËM SPORTIN DHE
TRASHËGIMINË NË PRIZREN** F. 16

Opozita harmonizon tekstin e mocionit ndaj qeverisë

| FAQE 3



Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Partia Socialdemokrate (PSD) kanë harmonizuar tekstin e mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë Haradinaj. Për këtë qëllim, kryetari i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, ka takuar të premtin kryetarin e grupit parlamentar të LV-së, Glauk Konjufca, deputetët e PSD-së dhe ata të Alternativës. Zyrtarët e këtyre subjekteve politike kanë treguar se deri më tani i kanë siguruar 58 nënshkrime, duke shtuar se nuk do t'i kërkojnë votat e Listës Serbe

**Sulmohet sërish gruaja rome, reagojnë
përfaqësuesit e institucioneve** | FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Holanda kërkon pezullimin e vizave për shqiptarët

HAGË, 31 MAJ - Parlamenti i Holandës i ka kërkuar të premtën zyrtarisht Komisionit Evropian pezullimin e vizave për Shqipërinë. Kërkesa e Holandës i është dorëzuar komisionarit për Sigurinë e Brendshme, Dimitris Avramopoulos.

Ky është rasti i parë kur një vend anëtar i BE-së kërkon nxjerrjen e një vendi tjetër nga zona

Shengen e lëvizjes së lirë. Nëse kërkesa do të miratohet nga institucionet e BE-së, gjithë qytetarët shqiptarë do ta kenë të pamundur që të lëvizin në të gjithë vendet e BE-së.

Më 16 prill, në një votim të paprecedent, Parlamenti holandez votoi me 105 vota nga 150 rikthimin e regjimit të vizave për qytetarët shqiptarë. Për rivendosjen e vizave votuan 9 parti politike në Holandë, nga të cilat 3 parti janë pjesë e qeverisë. Pjesë e votimit ku kërkohej pezullimi i vizave janë edhe partitë e dy ministrave, atij të Jashtëm e atij të Drejtësisë, që më herët patën thënë se Shqipëria i plotëson kriteret e veprimit në Shengen. Rikthimi i vizave u argumentua, sipas deputetëve holandezë, me

nivelin e lartë të krimit në radhët e qytetarëve shqiptarë që vizitojnë këtë vend. Gjithashtu, autoritetet holandeze kanë pasur rezerva edhe për bashkëpunimin me Ministrinë e Brendshme të Shqipërisë në luftën kundër krimit dhe trafikëve. Një vendim i tillë u shpjegua nga Qeveria shqiptare me fushatën

për zgjedhjet në BE dhe me faktin se një pjesë e partive në Holandë kërkonin të fitonin pikë në elektorat duke paraqitur një politikë më të ashpër ndaj emigrantëve dhe krimit. Por, fakti është se dokumenti i drejtohet KE-së pas përfundimit të zgjedhjeve për Parlamentin Evropian dhe tashmë ka hyrë në agjendën zyrtare të Brukselit.

Sekretari i NATO-s nesër viziton Tiranën

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, do të arrijë nesër (e diel) për një vizitë disaorëshe në Tiranë, ku pritet të zhvillojë takime me presidentin Ilir Meta, kryeministrin Edi Rama dhe ministren e Mbrojtjes Olta Xhaçka



HIRANË, 31 MAJ - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, do të udhëtojë për një vizitë disaorëshe në Tiranë, nesër (e diel). "Të dielën, më 2 qershor, sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, do të zhvillojë një vizitë në Tiranë", thuhet në njoftimin për medie të Aleancës Veriatlantike. Me këtë rast, shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg, do të zhvillojë një takim me presidentin Ilir Meta, kryeministrin Edi Rama dhe ministren e Mbrojtjes Olta Xhaçka.

Stoltenbergu do të mbajë një konferencë për medie me kryeministrin Rama në orën 15:20 minuta.

Përpara mbërritjes në Shqipëri të sekretarit të përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg, për një vizitë disaorëshe dhe

takime me krerët më të lartë të shtetit, ushtria ndërmerr një stërvitje.

Qëllimi i kësaj stërvitje ishte trajnimi, aftësimi dhe certifikimi i personelit të ndërlidhjes që mbulon pozicionet e punës si administratorë të rrjeteve kompjuterike; operatorë/radistë të radio-sistemit RF-5800; specialistë të IT dhe telekomunikacionit dhe specialistë për mbrojtjen kibernetike për kryerjen e detyrës funksionale.

Stërvitja u konceptua si stërvitje paradisloukuese dhe në këtë stërvitje morën pjesë të gjithë strukturat e ndërlidhjes në FA (me dislokim të elementëve të qendrave të lëvizshme të ndërlidhjes të FT dhe ASNI), me synim testimin e sistemeve të ndërlidhjes dhe informacionit në mbështetje të komandim-kontrollit për mbështetjen me SNI, të

stërvitjes "Albanian Effort - 19". Në përshëndetjen e tij drejtuar të gjithë pjesëmarrësve në këtë stërvitje, gjeneralbrigade Kollçaku gjatë fjalës së tij theksoi se stërvitja "Ndërveprimi - 19" zhvillohet në kohën e përpjekjeve për

modernizimin dhe zhvillimin e SNI të FA, në kohën e zhvillimeve të shpejta shkencore të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në kohë reale dhe virtuale pa kufizime distancore, të sfidës së ruajtjes,

mbrojtjes dhe përpunimit të informacionit nga përdoruesit legjitimë, të arritjes dhe ruajtjes së nivelit të ndërveprueshmërisë së sistemeve të ndërlidhjes dhe informacionit të FA me ato të NATO dhe vendeve aleate.

Maqedonia e Veriut kundërshton korigjimin e kufijve

SHKUP, 31 MAJ - Ideja për korigjimin e kufijve apo shkëmbimi i territoreve në mes të Kosovës dhe Serbisë për presidentin e Maqedonisë së Veriut Pendarovski, është e patolerueshme pasi, sipas tij, një vendim i tillë do të prod-

honte gjithmonë probleme mes dy shteteve. Pendarovski tha se institucionet e Kosovës dhe Serbisë duhet të fokusohen në krijimin e kushteve për bashkëjetesë e jo për ndarje. "Është e patolerueshme që të flitet për

një ide të tmerrshme për shkëmbim territoresh në shekullin 21. Herën e fundit një gjë e tillë ka ndodhur me mbështetjen e fuqive të mëdha para rreth një shekulli, në vitin 1923. Pyetni grekët dhe turqit se si edhe ditëve të

sotme kanë pasojë nga shkëmbimi i territoreve. Nuk mund as të mendoj se mund të ndodhë diçka më e keqe sesa dikush të mendojë seriozisht t'i qaset ekzekutimit të një projekti të tillë", tha presidenti Stevo Pendarovski.

Kurse ministrja e Mbrojtjes, Radmilla Sheqerinska, thotë se tensionet mes shteteve fqinje ndikojnë negativisht në të gjithë rajonin. Ajo tha se me anëtarësimin në NATO, vendi do të jetë i sigurt nga çfarëdo loj ndikimi nga jashtë.

Basha fton qytetarët në protestën mbarëpopullore të dielën

Tiranë, 31 maj - Lideri demokrat Lulzim Basha turin e takimeve e vijoi me banorë të zonës së Kombinativit në Tiranë ku, përveç akuzave për Edi Ramën, dha mesazhe të qarta edhe për protestën e nesërme (e diel). Basha e lëshoi gjuhën, teksa përmendi se "ata që sot drejtojnë janë horra" dhe se "ka ardhur

koha të shporren". Basha tha se kush pret nga Rama, e ka tërësisht gabim, ndaj kërkoi që protestës mbarëpopullore t'i bashkohen të gjithë, duke mos lënë pa përmendur aferën korruptive të rrugës Milot - Ballëdren.

Basha tha se Rama fut në burg ata që nuk kanë sot mundësi për

të jetuar, teksa tha se oligarkët si Vangjush Dako, Damian Gjinkuri e të tjerë vijnë të pasurohen e të vjedhin. Duke folur për protestën e nesërme (e diel), ai tha se nuk do të jetë e fundit, por javë për javë. Sipas tij, pjesëmarrja, qëndresa do ta largojnë atë si kryeministër dhe largimin e oligarkëve.



Partitë opozitare kanë mbledhur 58 nënshkrime për mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë

Opozita harmonizon tekstin e mocionit ndaj qeverisë

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Partia Socialdemokrate (PSD) kanë harmonizuar tekstin e mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë Haradinaj. Për këtë qëllim, kryetari i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, ka takuar të premten kryetarin e grupit parlamentar të LV-së, Glauk Konjufca, deputetët e PSD-së dhe ata të Alternativës. Zyrtarët e këtyre subjekteve politike kanë treguar se deri më tani i kanë siguruar 58 nënshkrime, duke shtuar se nuk do t'i kërkojnë votat e Listës Serbe

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 31 MAJ - Pas takimit të krerëve të partisë, një takim tjetër për t'u marrë vesh rreth rrëzimit të qeverisë Haradinaj e kanë organizuar edhe shefat e grupeve parlamentare të subjekteve opozitare. Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, dhe ai i Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, kanë harmonizuar tekstin e mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë. "Kryetari i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, së bashku me kryetarin e grupit parlamentar të VV-së, Glauk Konjufca, sot kanë harmonizuar tekstin e mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës. Hoti sot është takuar edhe me përfaqësuesin e grupit parlamentar të PSD-së dhe deputetin Ilir Deda, si dhe ka komunikuar me deputeten Mimoza Kusari Lila, për të diskutuar për mocionin e mosbesimit ndaj Qeverisë së PAN-it", është thënë në komunikatën e lëshuar nga zyra për media e LDK-së.

Më pas vetë shefi i grupit parlamentar, Avdullah Hoti, u ka bërë thirrje të gjithë partive që t'i bashkohen nismës për rrëzimin e qeverisë. "Sot me LV-në kemi harmonizuar tekstin e mocionit të mosbesimit ndaj

Ndërsa deputetja e LDK-së, Vjosa Osmani, në një konferencë për media ka bërë me dije se deri më tani ky subjekt politik i ka siguruar 58 nënshkrime për rrëzimin e qeverisë. Ajo ka thënë se nuk i kanë kërkuar votat e Listës Serbe për ta rrëzuar qeverinë. "Ne i kemi mbledhur 58 nënshkrime, por këto janë vetëm vota të opozitës. Ne nuk i kërkojmë votat e Listës Serbe. Ne synimin sot nuk e kemi të përgatisim nënshkrime, mirëpo se si do të jetë vota individuale nuk është çështje që ne e kontrollojmë", ka thënë Osmani.

Edhe deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, ka thënë se nuk do t'i kërkojnë votat e Listës Serbe për rrëzimin e qeverisë. "Ka kohë që, përveçse opozita nuk i ka numrat e mjaftueshëm për rrëzimin e qeverisë, as qeveria nuk e ka mazhorancën. Në mes të palëve gjendet Lista Serbe me të cilën ne nuk bashkëpunojmë, nuk ia

kërkojmë votat e as nuk llogarisim në votat e saj për rrëzimin e qeverisë, ashtu siç as nuk mund t'ia imponojmë se si do të sillet dhe si do të votojë në Kuvend në rast mocioni për rrëzimin e qeverisë. Kurdo që koordinohemi me deputetët që e duan rrëzimin e qeverisë ne do të shkojmë drejt mocionit", ka theksuar Selimi për "Epokën e re".

Ai ka thënë se, pavarësisht prej dallimeve, pika e përbashkët e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) është rrëzimi i qeverisë. "Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës janë subjekte parlamentare opozitare dhe bashkëpunimi opozitar është mjaft i natyrshëm. Me gjithë dallimet që i kemi si subjekte të ndara politike, rrëzimi i qeverisë është pika jonë e përbashkët", është shprehur Selimi, duke shtuar se ky bashkëpunim po pritet me optimizëm nga qytetarët si

mënyra më e lehtë për t'u çliruar nga qeverisja e tanishme. "Ne nuk jemi të përqendruar në të kaluarën në mes të LV-së dhe LDK-së kur ishim në raporte oponente në Kuvend. Tani jemi dy subjektet më të mëdha opozitare, rrjedhimisht edhe parlamentare, dhe bashkëpunimin nuk e pengon e kaluara oponente në mes të këtyre dy subjekteve. Me gjithë bashkëpunimin e deritanishëm opozitar, jemi subjekte të ndryshme ku dallimet, sado qofshin të mëdha, nuk na ndajnë në qëndrimet tona për qeverisjen aktuale", ka deklaruar Selimi.

Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ditë më parë ka paralajmëruar mocion mosbesimi ndaj qeverisë. Për këtë qëllim, Mustafa ka takuar edhe liderin e LV-së, Albin Kurti dhe atë të PSD-së, Shpend Ahmeti, ku janë pajtuar për rrëzimin e qeverisë dhe shkuarjen në zgjedhje të parakohshme.



Bujar Tërstena (RFE/RL)

Sulmohet sërish gruaja rome, reagojnë përfaqësuesit e institucioneve



PRISHTINË, 31 MAJ (ER) - Të premten është sulmuar në Ferizaj një grua rome, e cila një sulm të njëjtë e kishte pasur ditë më parë edhe në Lipjan nga disa qytetarë. Përfaqësuesit e institucioneve të vendit kanë thënë se është krejtësisht e papranueshme dhe shumë e dënueshme dhuna kundër cilitdo në Kosovë. Sulmin kundër një genie nuk e arsyeton as përkatësia e ndonjërit komunitet e aq më pak raportimet e paverifikuara në mediat sociale

apo në ndonjë portal. Ftoj për sjellje të përgjegjshme e qytetare të çdo kosovari, për raportim të përgjegjshëm të mediave dhe për veprim të menjëhershëm e të rreptë të organeve të rendit për të mbrojtur çdo njeri në Kosovë. Në Kosovën tonë nuk do të ketë vend për dhunë", ka thënë presidenti Hashim Thaçi në reagimin e tij.

Edhe kryeparlamentari Kadri Veseli ka thënë se është i shokuar me këtë rast. "Jam i shokuar me pamjet e sulmit

ndaj një qytetare të lirë të këtij vendi. Veprime të tilla janë të papranueshme", ka thënë Veseli. Po ashtu, ndaj këtij rasti ka reaguar edhe kryeministri Ramush Haradinaj, i cili ka thënë se agresioni i shfrenuar i disa adoleshentëve në Lipjan dhe Ferizaj ndaj qytetarëve, për shkak të përkatësisë së tyre etnike, është i turpshëm dhe i dënueshëm. Ndaj këtij sulmi kanë reaguar edhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe të komunitetit rom.

Flet për "Epokën e re", Bashkim Ramosaj

Është e padrejtë kërkesa që t'ia japim



Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, e ka quajtur "vetëvrasje" për këtë komunë zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për t'ia dhënë 24 hektarë tokë Manastirit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se është i padrejtë ky vendim sepse e ngulfat zhvillimin ekonomik të Komunës së Deçanit. Ramosaj ka shprehur gatishmërinë për gjetjen e një zgjidhje në mes të komunës dhe Manastirit pa iu nënshtuar vendimit të Kushtetueses. Sipas tij, është e drejtë natyrore e popullit t'i shfrytëzojë potencialet dhe resurset që Zoti ia ka dhënë Deçanit. Ai u ka bërë thirrje institucioneve vendore dhe ndërkombëtare që të angazhohen për një zgjidhje të përbashkët e cila do t'i kënaqte të dyja palët

EPOKA E RE**Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 31 MAJ - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka thënë të premtën se nuk do ta zbatojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese për t'ia dhënë 24 hektarë Manastirit të Deçanit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se zbatimi i këtij vendimi është "vetëvrasje" për këtë komunë dhe qytetarët e saj. "Në asnjë rrethanë nuk do të zbatohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese sepse në një farë mënyre është 'vetëvrasje'. Është i padrejtë presioni dhe kërkesa që t'ia japim 24 hektarë

Manastirit. Nuk bëhet fjalë vetëm për 24 hektarë, mirëpo për një varg pasojash. Është zona e veçantë e mbrojtur, ndërtimi i rrugës që është arteria kryesore e zhvillimit, trajtimi i lumit, trajtimi i pronave private, trajtimi i pushimores, kampi, hoteli, baseni olimpik, si dhe trajtimi i fshatrave sipër Manastirit që nuk kanë as rrymë e as ujë", ka deklaruar Ramosaj, duke shtuar se është i padrejtë ky vendim sepse e ngulfat zhvillimin ekonomik të Deçanit. "Vendimi i Gjykatës Kushtetuese i 19 majti të vitit 2016 është i padrejtë për të vetmen arsye se e ngulfat zhvillimin ekonomik të

Komunës së Deçanit, që do të thotë se shuhet shpresa e qytetarëve për të jetuar në këtë vend. Manastiri i Deçanit nuk ka të drejtë t'i ketë 24 hektarë", ka theksuar ai. Sipas Ramosajt, është e drejtë natyrore e popullit t'i shfrytëzojë potencialet dhe resurset që Zoti ia ka dhënë Deçanit. Ai u ka bërë thirrje institucioneve vendore dhe ndërkombëtare që të angazhohen për një zgjidhje të përbashkët e cila do t'i kënaqte të dyja palët. "Para disa ditësh kemi mbajtur një mbledhje të jashtëzakonshme ku është formuar një këshill organizativ që më 6 qershor të mbahet një protestë e cila ka pasur për objektiv që t'i ftojë

Manastirin dhe ambasadat për t'u angazhuar për gjetjen e një zgjidhje të përbashkët e cila do t'i kënaqte të dyja palët. Por nga institucionet qendror na është kërkuar që ta shtyjme protestën për një datë të pacaktuar. Ne jemi pajtuar me këtë kërkesë me qëllim që të gjendet një zgjidhje e përbashkët. Mendoj se duhet ta bëjmë një zgjidhje sepse është e domosdoshme. Është e papranueshme të kërkohet nga qytetarët e Deçanit që të mos kenë koncept të saktë të zhvillimit ekonomik, që praktikisht i bie që qytetarët e Deçanit duhet të largohen prej kësaj komune", ka deklaruar Ramosaj.

"Epoka e re": Kryetar, Komuna e Deçanit nuk po pranon ta zbatojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese për dhënien e 24 hektarëve Manastirit të Deçanit. Pse po hezitoni?
Ramosaj: Sepse vendimi i Gjykatës Kushtetuese i 19 majti të vitit 2016 është i padrejtë për të vetmen arsye se e ngulfat zhvillimin ekonomik të Komunës së Deçanit, që do të

thotë se shuhet shpresa e qytetarëve për të jetuar në këtë vend. Manastiri i Deçanit nuk ka të drejtë për t'i pasur 24 hektarë.

"Epoka e re": Deri kur do të vazhdojë kjo gjendje meqë vendimet e gjykatës duhen zbatuar?

Ramosaj: Në çdo takim kemi shprehur gatishmërinë për të bërë një zgjidhje të përbashkët pa iu nënshtuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese sepse gjeneza e këtij vendimi daton në vitin 1992, kur shqiptarët në Deçan, sidomos punëtorët që kanë punuar në ato ndërmarrje, janë larguar dhunshëm prej punës. Një ndërmarrje e dhunshme, po ashtu dhuratën e parë ia ka bërë Manastirit. Në kontestin e vitit 1992 në Deçan ka pasur demonstrata, njerëz të vdekur, të plagosur dhe nxënës të helmuar. Manastiri ka gabuar kur ka pranuar këtë dhuratë në ato kushte. Madje ka vazhduar edhe në vitin 1997 kur, dikur në tetor, Kuvendi i Serbisë ia bëri dhuratë 24 hektarë tokë Manastirit. Në vitin 1999, administrata e

24 hektarë tokë Manastirit të Deçanit



"Epoka e re": Cilat janë rrugët që do t'i ndiqni për të pasur sukses në këtë drejtim?

Ramosaj: Para disa ditësh kemi mbajtur një mbledhje të jashtëzakonshme, ku është formuar një këshill organizativ, që më 6 qershor të mbahet një protestë, e cila ka pasur për objektive që ta ftojë Manastirin dhe ambasadat për t'u angazhuar për gjetjen e një zgjidhje të përbashkët që do t'i kënaqte të dyja palët. Por nga institucionet qendrore na është kërkuar ta shtyjme protestën për një datë të pacaktuar. Ne jemi pajtuar me këtë kërkesë me qëllim që të gjendet një zgjidhje e përbashkët. Mendoj se duhet ta bëjmë një zgjidhje, sepse është e domosdoshme. Është e papranueshme të kërkohej nga qytetarët e Deçanit që të mos kenë koncept të saktë të zhvillimit ekonomik, që praktikisht i bie që qytetarët e Deçanit

duhet të largohen prej kësaj komune.

"Epoka e re": Prisni reflektim nga Manastiri?

Ramosaj: Dua të besoj dhe shpresoj që edhe Manastiri duhet të jetë pjesë e konceptit tonë zhvillimor sepse, pavarësisht prej të gjithave, Manastiri dhe qytetarët do të qëndrojnë aty. Prandaj, është tepër e nevojshme të jetojmë në një harmoni duke e respektuar njëri-tjetrin dhe duke ia arsyetuar nevojat njëri-tjetrit.

"Epoka e re": Në rast se nuk arrini të merreni vesh, kjo çështje mund të procedohet në ndonjë gjykatë ndërkombëtare?

Ramosaj: Nuk e besoj, sepse është një vendim i gjykatës i paankimuar në këtë rast dhe Kosova nuk ka subjektivitet ligjor që t'i drejtohet Gjykatës së Strasburgut, që është e

vetmja që i trajton këto çështje. Besoj në një zgjidhje, sepse është e drejtë natyrore e këtij populli t'i shfrytëzojë potencialet dhe resurset që Zoti ia ka dhënë këtij qyteti.

"Epoka e re": Sa të jeni ju kryetar vendimi nuk do të zbatohet?

Ramosaj: Jo, absolutisht. Në asnjë rrethanë nuk do të zbatohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese, sepse në një farë mënyre është 'vetëvrasje'. Është i padrejtë presioni dhe kërkesa që t'i japim 24 hektarë tokë Manastirit. Nuk bëhet fjalë vetëm për 24 hektarë, mirëpo për një varg pasojash. Është zona e veçantë e mbrojtur, ndërtimi i rrugës që është arteria kryesore e zhvillimit, trajtimi i lumit, trajtimi i pronave private, trajtimi i pushimores, kampi, hoteli, baseni olimpiq, si dhe trajtimi i fshatrave sipër Manastirit që nuk kanë as rrymë e as ujë.

MPJ-ja kërkon nga qytetarët që përkohësisht ta evitojnë qarkullimin përmes Serbisë

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 31 MAJ - Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) nëpërmjet një komunikatë për medie ka kërkuar të premtën nga qytetarët e Republikës së Kosovës, me vendbanim brenda apo jashtë vendit, që të shfaqin kujdes dhe maturi në rast se nuk mund ta shmangin qarkullimin nëpër territorin e Serbisë. "Në përputhje me obligimin institucional dhe ligjor për ta informuar publikun dhe për t'u kujdesur për sigurinë dhe integritetin e secilit qytetar të Kosovës, Ministria e Punëve të Jashtme vlerëson se Serbia nuk është më një territor i cili ofron as siguri minimale për integritetin e tyre fizik dhe juridik, as për familjarët e tyre. Për rrjedhojë, MPJ-ja sugjeron evitim të përkohshëm të qarkullimit përmes Serbisë", bëhet me dije në një komunikatë të MPJ-së. "Qytetarë të dashur, dëshirojmë të kemi vëmendjen tuaj, pasi që ky njoftim vjen si rezultat i arrestimeve të vazhdueshme të qytetarëve të Republikës së Kosovës nga ana e institucioneve të këtij vendi, gjithmonë në rrethana fiktive. Një numër i tyre madje edhe janë keqtrajtuar fizikisht dhe psikikisht. Bazuar në këto zhvillime, Ministria e Punëve të Jashtme ka bazë dhe evidencë të

mjaftueshme të konstatojë që ndaj të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, Serbia, pa përjashtim, për qëllime politike dhe të tjera jodemokratike, në kundërshtim me praktikën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar dhe me të drejtën ndërkombëtare dhe atë evropiane si dhe në kundërshtim me obligimet që dalin nga marrëveshjet e Brukselit, jashtëligjshëm mund t'ju ndaloj arbitrarisht kalimin në territorin e saj", është thënë në komunikatën e MPJ-së.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe të gjitha institucionet e vendit i kanë ftuar dhe vazhdojnë t'i ftojnë institucionet e Bashkimit Evropian që ta korrigojnë këtë sjellje agresive të Serbisë por që, fatkeqësisht, deri më tani kjo nuk

ka pasur asnjë efekt. "Ndryshe nga këto praktika primitive të Serbisë, Republika e Kosovës vepron në formë të matur, të civilizuar dhe demokratike dhe, për dallim, nuk i trajton qytetarët e Serbisë në forma joligjore dhe jodemokratike për aq kohë sa ata nuk janë të lidhur me krimin dhe i respektojnë ligjet e Republikës së Kosovës. Ftojme Serbinë që përfundimisht të heqë dorë nga praktikat fashiste dhe ta pranohet faktin që është pjesë e kontinentit evropian, ku liria e lëvizjes është e drejtë universale e secilit dhe respektohet pavarësisht prej agjendave politike", është theksuar më tutje në komunikatën e MPJ-së, duke treguar se ky njoftim mbetet në fuqi deri në një njoftim të dytë në lidhje me këtë zhvillim.



dhunshme e Serbisë, e cila ka bërë gjenocid në Kosovë, nuk e ka bartur këtë tokë nga Manastiri. Kurse në periudhën pas çlirimit, në kohën kur Kosova administrohej nga UNMIK-u, që është bërë çmos që ky vendim të hyjë në fuqi prej Gjykatës Komunale në Gjykatë të Qarkut e deri në Gjykatën Supreme në dhomën e posaçme për çështje që kanë të bëjnë me AKP-në si trashëgimtare e AKM-së, pra që të merret vendim absurd.

"Epoka e re": Ju po thoni se keni gatishmëri për të gjetur një zgjidhje pa e përfillur këtë vendim. Cila është ajo?

Ramosaj: Është një logjikë shumë e thjeshtë. Populli ynë ka një histori me plot vuajtje dhe tragjedi. Gjatë gjithë kësaj periudhe kemi bashkëjetuar me manastirin dhe e kemi respektuar atë. Tani një manastir që është i mbrojtur nga UNESCO, i cili prezanton kulturën dhe fenë, nuk duhet t'ia vrasë shpresën një komune të tërë duke ia pamundësuar zhvillimin ekonomik. Dëshirojmë që t'i kemi në

shfrytëzim potencialet dhe resurset që i ka Komuna e Deçanit. Kjo komunë e ka vetëm një sektor të sigurt të zhvillimit ekonomik dhe ai është turizmi. Po flasim për kapacitete shumë të mëdha. Nuk ka qasje në dy vendbanime sipër Manastirit. Nuk lejohet ndërtimi i rrugës, rryma, ndërtimi i shtratit të lumit, shfrytëzimi i pushimores, shfrytëzimi i Hotelit 'Iliria', shfrytëzimi i kampit 'Garibaldi' dhe një serë asetesh të tjera të rëndësishme ekonomike të kësaj komune.

"Epoka e re": Pavarësisht prej kësaj, ndërkombëtarët në vazhdimësi kanë bërë thirrje për zbatimin e vendimit. Ky presion a mund t'ju zbrapsë?

Ramosaj: Jo, në asnjë rrethanë. E kemi për obligim t'u shpjegojmë ndërkombëtarëve në mënyrë që e drejta të dalë në shesh, sepse deri më tani pala tjetër ka bërë propagandë saqë kanë filluar t'i bindin ndërkombëtarët edhe me argumente të rrejshme. Mirëpo me çdokënd që jemi takuar dhe që ia kemi treguar ecurinë e ngjarjes e ka kuptuar realitetin.

Vajza e Xhemajl Fetahajt: Babai im nuk i ka takuar asnjë krah, por vetëm UÇK-së

Të premten në Prishtinë është mbajtur akademi përkujtimore në 20-vjetorin e rënies së heroit të Kosovës, Xhemajl Fetahaj dhe bashkëluftëtarit të tij Milazim Shala. Në këtë akademi kanë marrë pjesë presidenti Hashim Thaçi, kryeministri Ramush Haradinaj, ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha, deputetë, përfaqësues të organizatave të dala nga lufta, qytetarë dhe familjarë



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 31 MAJ - Të premten është mbajtur akademi përkujtimore në 20-vjetorin e rënies së heroit të Kosovës, Xhemajl Fetahaj dhe bashkëluftëtarit të tij, Milazim Shala, në kuadër të Manifestimit Tradicional "Ditët e Shqipës 2019", që është organizuar nën përkujdesjen e kryeministrit. Në këtë akademi kanë marrë pjesë presidenti Hashim Thaçi, kryeministri Ramush Haradinaj, ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha, deputetë, përfaqësues të organizatave të dala nga lufta, qytetarë dhe familjarë.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se në prag të çlirimit të vendit tonë, para

njëzet vjetëve, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, krahas luftës heroike, pati edhe goditje. "Sot e njëzet vjet më parë ranë heroikisht bashkëluftëtarët tanë Xhemajl Fetahaj dhe Milazim Shala në Rrasën e Zogut, aty ku po thyhej përfundimisht kufiri Shqipëri - Kosovë", ka thënë presidenti Thaçi. Ai ka thënë se Xhemajl Fetahaj hyn në radhën e veprimtarëve dhe luftëtarëve që kanë një biografi të jashtëzakonshme në rrugën e realizimit të idealit të tyre për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. "Xhemajl Fetahaj si pjesëtar i organizatave çlirimtare, si student i historisë përjetoi burgun, prej nga e forcoi edhe më shumë bindjen për të punuar edhe më shumë kundër sundimit serb të Kosovës. Pas daljes nga burg ai dha një kon-

tribut të çmuar në lëvizjen për pajtim dhe kundër hakmarrjes", ka theksuar Thaçi.

I pari i vendit ka thënë se Xhemajl Fetahaj për t'i ikur arrestimit të dytë përjeton mërgimin, por asnjëherë nuk e ndali aktivitetin kombëtar për çlirimin e Kosovës.

Kryeministri Ramush Haradinaj, duke evokuar kujtime nga e kaluara, ka thënë se janë mbledhur

sot për ta shprehur respektin për bashkëluftëtarët shumë të zotë, heronjtë tonë që i bashkoi lufta për liri, që i bashkoi Brigada emblemë 138 "Agim Ramadani" dhe që i bashkoi epopeja e UÇK-së në Koshare, e cila, siç tha kryeministri, vërtet i dha dimension tjetër luftës sonë për liri. "Secili nga ne përpiqemi të nxjerrim në dritë të vërtetën për këta bashkëluftëtarë, sepse kemi çfarë të tregojmë për këta heronj të shquar dhe t'ua themi brezave", ka thënë kryeministri Haradinaj.

Në fjalën e tij para të pranishmëve të shumtë, Haradinaj ka thënë se sa i përket familjes Fetahaj në Raushiq, është një familje që ka tradita të atdhedashurisë për atdheun dhe për kombin e që është e gjatë, ndër breza. "Është një familje tipike shqiptare e çmuar dhe e respektuar nga të gjithë dhe nuk është aspak çudi që Xhemajli dhe gjithë familja janë ndodhur në vijat e para të frontit me fillimin e luftës kombëtare në Dukagjin, fillimisht në Glogjan, pastaj zonat përreth", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke theksuar se është me të vërtetë një rast i çmuar dhe mirë i paraqitur se si një familje shqiptare me atdhedashuri të ngulitur në vete nëpër dekada e breza, menjëherë kur është

shfaqur nevoja për t'i dalë zot atdheut, është mobilizuar vetë, ka shkruar për furnizim dhe ka ndihmuar furnizimin e vendit, të atyre trevave dhe bashkëluftëtarëve të tjerë, duke përkrahur vijat e para të luftës. "Bëhet fjalë për ata që nuk kanë pritur që dikush t'i ftojë në luftën për liri, për të drejtën e atdheut, por ishin vetë aty", është shprehur kryeministri.

Duke folur për periudhën e luftës, kryeministri Haradinaj ka thënë se Baballoqi ka përjetuar intensitetin më të madh të luftimeve menjëherë në fillimet e vitit '98 dhe se e gjitha popullata e atij vendi pësoi goditjet dhe vuajtjet e para. "Nuk është rastësi që një djalë nga Baballoqi është gjetur krah për krah me Agimin, Saliun, Xhemajlin dhe me gjithë të tjerët përballë armikut, duke mos hequr dorë nga e drejta e tyre për liri", është shprehur kryeministri Haradinaj. Në këtë akademi përkujtimore ka folur edhe ministri i Mbrojtjes, Rrustem Berisha.

Në emër të familjarëve, të pranishmit i ka përshëndetur Erëza Fetahaj, vajza e heroit Xhemajl Fetahaj. Ajo ka thënë se babai i saj nuk i ka takuar asnjë krah, por vetëm UÇK-së. "Ai nuk i ka takuar asnjë krah, por vetëm UÇK-së", ka thënë Erëza Fetahaj.



Ushtrisë së Kosovës i shtohen edhe dy pilotë

PRISHTINË, 31 MAJ (ER) - Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) po i shtohen radhët me kuadro të reja oficerësh, profilesh të ndryshme, për të qenë forcë profesionale dhe e ndërveprueshme me ushtritë e tjera mbi bazën e standardeve të NATO-s.

Në vazhden e sukseseve të

arsimit dhe profesionalizimit janë edhe dy oficerë të rinj, pilotët e ushtrisë së Kosovës, nëntoger Atdhe Hasani dhe nëntoger Krenar Voca, të cilët përfunduan me rezultate të shkëlqyera shkollimin profesional për pilot helikopteri në Akademinë Ushtarake "Kara Havacilik Okulu" në

Republikën e Turqisë. Nëntoger Atdhe Hasani, me suksesin e treguar gjatë shkollimit, ka arritur që të radhitet i dyti në mesin e kadetëve më të mirë të gjeneratës. Në ceremoninë e diplomimit i pranishëm ishte atasheu i FSK-së i akredituar në Turqi, kolonel Bekim Osmani.



Kosova e shpallë rusin e arrestuar në veri person 'non grata', kërkon largimin e tij

PRISHTINË, 31 MAJ - Qeveria e Kosovës e ka shpallur person "non-grata" (të padëshirueshëm) punonjësin rus të Misionit të Kombeve të Bashkuara (UNMIK), Mikhail Krasnoshchenkov. Lajmin e ka bërë me dije të premtën kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook". Vendimi, sipas kryeministrit, është marrë për shkak të veprimeve të shtetasit rus kundër rendit kushtetues të Kosovës. "Vendimi është marrë sot ndaj këtij personi që punon si staf ndërkombëtar në Kombet e Bashkuara dhe të njëjtit i urd-

hërohet që ta lëshojë territorin e Republikës së Kosovës. I bëj thirrje Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë ta respektojë vendimin", ka shkruar kryeministri Haradinaj.

Deri më tani UNMIK-u nuk është deklaruar për vendimin e autoriteteve të Kosovës. Megjithatë, bazuar në një deklaratë të mëparshme të zëdhënësit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Antonio Guterres, "doktrina e personave 'non grata' nuk është e zbatueshme për personelin e Kombeve të Bashkuara". Ky



qëndrim u tha kur Qeveria e Somalisë e shpalli person "non grata" Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm në

Somali, Nicholas Haysom. Prokuroria Themelore në Mitrovicë, përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme të Qeverisë

së Kosovës, ka kërkuar heqjen e imunitetit të shtetasit rus dhe punëtorit të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë - UNMIK. Ndërkohë, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë përmes një komunikate për media të enjten, tha se secila kërkesë për heqje të imunitetit do të dërgohet nga UNMIK-u në selinë e Kombeve të Bashkuara dhe do të trajtohet në përputhje me procedurat e OKB-së.

UNMIK-u njoftoi se pjesëtari rus i këtij misioni, që është arrestuar dhe më pas liruar në Kosovë, është transferuar në Beograd për trajtim mjekësor.

Ambulancat e reja specialiste për katër muaj ofruan 51 mijë shërbime për pacientët

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 31 MAJ - Ambulancat e reja specialiste në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) kanë ofruar më shumë se 51 mijë shërbime për pacientët gjatë katër muajve të parë të vitit 2019. Numri i trajtimit të rasteve është rritur dukshëm në krahasim me vitet e kaluara, me ndërtimin e objektit të ri, një investim i bërë nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe Ministria e Shëndetësisë (MSh), i cili ofron hapësirë për operim të 36 ambulancave specialiste. Me një infrastrukturë moderne dhe pajisje të dorës së fundit, ambulancat specialiste japin mundësi më të mira tretmani për pacientët dhe kushte më të përshtatshme pune për stafin shëndetësor.

Instalimi i sistemit modern të menaxhimit në hapësirat e reja ka vënë rend e rregull dhe ka eliminuar tollovitë dhe



mundësitë për kontrolle mjekësore pa rend, kthyer në një fenomen më herët te ambulancat e vjetra në bodrum, të cilat

nuk siguronin as kushte minimale. Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës dhe

Ministria e Shëndetësisë gjatë këtij viti kanë planifikuar investime të tjera në infrastrukturë dhe pajisje të reja.

511 fëmijë kërkuar ndihmë mjekësore në Emergjencën Pediatrike për një javë

Emergjencja Pediatrike në QKUK për një javë ka pasur 511 fëmijë që kanë kërkuar ndihmën mjekësore si pasojë e shqetësimeve të ndryshme shëndetësore. Sipas raportit javor të Klinikës së Pediatrisë, për një javë në ambulancat specialiste ka pasur 380 vizita mjekësore të fëmijëve. Ndërkaq përgjatë javës në këtë klinikë janë pranuar 96 raste për trajtim të mëtejshëm.

Përurohet shtëpia muze e Katarina Josipit

PRIZREN, 31 MAJ (ER) - Në fshatin Zym të Prizrenit është bërë përurimi i shtëpisë muze të aktores së madhe dhe ikonike të Kosovës, Katarina Josipi, projekt në të cilin Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka investuar rreth 50 mijë euro, e cila është një monument i trashëgimisë kulturore në Zym të Prizrenit dhe që i përket kategorisë arkitekturore. Në ceremoninë e përuimit mori pjesë edhe ministri Kujtim Gashi e cili vlerësoi se gradualisht fshati Zym po shndërrohet në një pikë turistike të Kosovës. "Është kënaqësi e veçantë që të marrim pjesë në

një fshat të veçantë të Kosovës, i cili trajtohet me një ligj të veçantë, Ligjin për fshatin Zym dhe pa dyshim se përkushtimi ynë për këtë vendbanim të rëndësishëm të veçantë dhe të trashëgimisë kulturore, por edhe i imi si ministër, është tejet i rëndësishëm. Edhe më herët disa ministra janë marrë me këtë projekt, i cili është stërzgatur shumë. Ne, duke pasur parasysh rëndësinë dhe specifikat që ka pasur ky projekt, natyrisht që është dashë një punë e madhe dhe përkushtim për ndryshim brenda projektit", ka thënë ministri Gashi.



Dialogu publiko-privat, parakusht për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik



PRISHTINË, 31 MAJ (ER) - Rritja e komunikimit në mes të sektorit publik dhe atij privat është parakusht për nxitjen e rritjes ekonomike, përmirësimin e mjedisit afarist dhe fuqizimin e sundimit të ligjit. Kështu u tha në tryezën e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë me anëtarët e Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri

dhe Zhvillim Rajonal. Presidenti i Bordit të Guvernatorëve të Odës Amerikane, Ilir Ibrahim, ka theksuar se organizimi i tryezave të tilla i shërben krijimit të një platforme ku adresohen shqetësimet e bizneseve dhe shkëmbehen rekomandime lidhur me mënyrat të cilat garantojnë zhvillimin ekonomik të vendit. Ibrahim ka theksuar se në të

kaluarën ka pasur luhatje të nivelit të dialogut në mes të sektorit publik dhe atij privat, duke sugjeruar krijimin e një kanali të mirëfilltë të dialogimit në këtë drejtim.

Kryetarja e Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, Sala Berisha-Shala, ka theksuar se Oda Amerikane mbetet partnere shumë e

rëndësishme për çështjet të cilat afektojnë operimet e bizneseve, andaj bashkëpunimi me komisionin të cilin ajo drejton është i domosdoshëm.

Ndërsa zëvendëskryetari i këtij Komisioni, Dardan Sejdiu, ka potencuar se bashkëpunimi me odat ekonomike gjatë kësaj periudhe është tejet i rëndësishëm, marrë parasysh se brenda vitit parashihet të hartohen edhe Ligji për Tregti të

Brendshme dhe të Jashtme. Ai bëri thirrje për pjesëmarrje aktive në dëgjimet publike të këtij komisioni parlamentar. Më tutje, përfaqësuesit e bizneseve diskutuan lidhur me çështjet të cilat afektojnë sektorin e prodhimit, tregtisë dhe teknologjisë informative dhe zhvillimin ekonomik në tërësi, duke kërkuar rritje të dialogut të mirëfilltë mes sektorit publik me atë privat.

Sqarim nga KEDS-i dhe KESCO për taksën e RTK-së

PRISHTINË, 31 MAJ (ER) - KEDS-i dhe KESCO përmes një komunikate për media kanë bërë me dije se kanë mësuar nga mediat fillimisht se ekziston, pastaj që ka kaluar në lexim të parë Projektligji për RTK-në, ku parashihet që taksë të inkasohet nga kompania. "KEDS-i dhe KESCO nuk dëshirojnë në asnjë rrethanë të interferojnë në punën dhe vendimet e deputetëve. Por, meqenëse është apostrofuar emri i kompanisë si përfituese nga ky projektligj, ne e bëjmë të qartë se nuk kemi asnjë përfitim nga ajo taksë. Për më tepër, duke e ditur se KEDS-i dhe KESCO janë kompani të rregulluara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) dhe ky institucion është i themeluar nga Kuvendi i Kosovës dhe i jep përgjegjësi këtij institucioni, kërkojmë

nga të gjithë deputetët dhe partitë parlamentare që para se të dalin me konstatime se KEDS-i përfiton diçka nga kjo taksë, të marrin informacione nga ky institucion", është thënë në komunikatën për media.

Më tej në këtë komunikatë theksohet se çdo kompani e rregulluar, në këtë rast edhe KEDS-i dhe KESCO i kanë të hyrat maksimale të lejuara, sikurse edhe fitimin e rregulluar, pra janë të përcaktuara strikt nga ZRRE. "KEDS/KESCO sqaron për opinionin se janë të fokusuar vetëm në çështjet e energjisë elektrike, përkatësisht distribuimin dhe furnizimin me energji elektrike dhe në asnjë aktivitet tjetër që interferon operimet tona", është thënë në komunikatën e KEDS-it dhe KESCO-s.



A ka ndikuar taksa në rritjen e kontrabandës në pjesën veriore të Kosovës?

PRISHTINË, 31 MAJ - Operacioni i Policisë së Kosovës në veri dhe jug të Mitrovicës, që rezultoi me ndalimin e disa zyrtarëve policorë dhe qytetarëve si të dyshuar për krim dhe kontrabandë, bie në kundërshtim me deklaratat e mëhershme të zyrtarëve institucionalë, se pas vendosjes së taksës 100 për qind për importet nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina, niveli i kontrabandës nuk është rritur, thonë ekspertë të çështjeve ekonomike.

Zbatimi i masës mbrojtëse ka filluar para gjashtë muajsh. Gjatë muajve të parë të zbatimit të taksës në treg nuk është vërejtur mungesë e produkteve nga këto shtete, përderisa zyrtarë të lartë të institucioneve dhe përfaqësues të institucioneve kompetente deklarorin se mallrat e reja të importuara nga këto vende nuk po hynin në mënyrë jologjore.

Adriatik Stavileci, zëdhënës në Doganën e Kosovës, pranon se kontrabanda është zhvilluar, por jo në përmasa të mëdha. Ai në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se nëse bëhet një krahasim me fazën para aplikimit të taksës, kur kontrabanda e mallrave është bërë në vlera më të madha, pas nëntorit është vërejtur se kontrabanda është zhvilluar me produkte me vlera më të ulëta. "Pra, prej 21 nëntorit 2018 (kur qeveria vendosi taksën 100 për qind), Dogana ka ndërmarrë të gjitha veprimet për zbatimin e vendimit të qeverisë. Fillimisht kemi vendosur masën e cila ka rritur kapacitetin e kontroleve në të gjitha pikat kufitare. Ekipet tona anti-kontrabandë e kanë rritur aktivitetin duke operuar 24 orë në të gjitha zonat ku dyshohet se ka kontrabandë, në veçanti në rajonin e Mitrovicës. Njësia anti-kontrabandë deri

tani ka ndërmarrë 1 050 aktivitete të planifikuara në zonat ku mendojmë se ka risk dhe kanë rezultuar me zbulimin e mallrave kontrabandë me mbi 250 raste", ka thënë Stavileci.

Policia e Kosovës ka zhvilluar të martën një operacion në veri dhe jug të Mitrovicës, i cili ka rezultuar me ndalimin e 19 zyrtarëve policorë dhe të disa qytetarëve. Siç kanë njoftuar zyrtarët e Prokurorisë Speciale të Kosovës dhe Policisë së Kosovës, aksioni policor kishte për qëllim luftimin e krimit dhe kontrabandës. Ky operacion ka përfshirë disa rajone të ndryshme, përfshirë komunat Zvečan, Zubin Potok, Leposaviq, Mitrovicë Veri, Mitrovicë Jug, Skenderaj dhe Drenas.

Naim Gashi, ekspert për çështje ekonomike, mendon se pretendimi i autoriteteve se nuk ka kontrabandë është joreal. Ai ka theksuar se për 20 vjet është

zhvilluar kontrabandë me mallra luksoze në veriun e Kosovës. Kurse, pas vendosjes së taksës, Gashi vlerëson se sa herë të ketë rritje të akcizës së doganës, atëherë rritet edhe tendenca e kontrabanduesve për të kontrabanduar mallra. "Unë nuk kam fakte se a ka pasur rritje apo jo. Mirëpo mund të them se me vetë vendosjen e barrierave tregtare për Serbinë është rritur edhe interesimi i kontrabandistëve dhe përfitimi i tyre ka qenë më i madh. Për vetë faktin se nëse kalojnë në pikat kufitare atëherë duhet të paguajnë 100 për qind taksë për prodhimet e Serbisë. Është fakt se edhe pas vendosjes së taksës një pjesë e madhe e mallrave nga Serbia janë parë në dyqanet e Kosovës dhe kjo tregon se çmimet e tyre nuk kanë qenë të dyfishuara në krahasim me politikat fiskale që ka vendosur Kosova në raport me prodhimet e Serbisë dhe

Bosnjës", ka thënë Gashi.

Ndërsa Adriatik Stavileci përmend pikat kufitare që konsiderohen më të favorshme për kontrabanduesit. "Disa pjesë në territorin e Kosovës në aspektin e Doganës vlerësohen se ka risk më të madh. Pjesa veriore e Mitrovicës përbën problem të kontrabandës. Në pjesën tjetër e kemi kufirin të Dheu i Bardhë, në pjesën e Gjilanit, gjithashtu edhe pikën kufitare të Vermicës që lidhet me Shqipërinë, e që paraqesin probleme", është shprehur Stavileci.

Edhe drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj, në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se nuk ka indikacione që tregojnë se ka rritje të shmangies tatimore në pjesën veriore të Kosovës, edhe pse e pranon se në atë pjesë të Kosovës nuk është gjendja e kënaqshme.



Telekomi i Kosovës, me kontratë të re kolektive

PRISHTINË, 31 MAJ (ER) - Kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi, së bashku me kryetarin e Sindikatës së Telekomit Lamih Balaj, të premtën kanë nënshkruar kontratën e re kolektive në Telekomin e Kosovës. "Kjo kontratë kolektive është përpiluar në përputhje me kontratën nacionale dhe përcakton në mënyrë të qartë marrëdhëniet mes Telekomit të Kosovës dhe punonjësve, ngrit ndjenjën e sigurisë, respektit dhe përgjegjë-

sisë në punë, si dhe përcakton zgjidhjen e drejtë dhe të paanshme të mosmarrëveshjeve të mundshme në të ardhmen", ka thënë kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi. Ai ka theksuar se nënshkrimi i kësaj kontrate krijon kanal të ri komunikimi, mundëson pjesëmarrjen e punonjësve në vendimarrje, njëherësh dëshmon se Telekomit i Kosovës, përveç zhvillimit të aktiviteteve të zakonshme biznesore, gjithashtu i kushton

rëndësi të veçantë raportit me punonjësit e vet. "Kontrata kolektive është e rëndësishme edhe për shoqërinë tonë në përgjithësi, pasi që krijon klimë të favorshme e cila ndihmon në përpjekjet e përgjithshme të vendit për zhvillim ekonomik dhe social. Me këtë rast dua t'i inkurajoj të gjithë kolegët tanë që ta vazhdojnë përkushtimin për kryerjen e punëve dhe detyrave të përditshme për zhvillimin e kompanisë sonë", ka thënë Istrefi.



Nxënësit e Shkollës Fillore 'Edmond Hoxha' vizitojnë stacionin e policisë në Junik

JUNIK, 31 MAJ (ER) - Komandanti i Stacionit Policor në Komunën e Junikut, togeri Rasim Sylja, së bashku me stafin ka pritur sot në takim nxënësit e Shkollës Fillore "Edmond Hoxha" me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve - 1 Qershorit. Komandant Sylja

ka bashkëbiseduar me nxënësit për rëndësinë e kësaj dite, 1 Qershorin, pastaj ka folur për punën në polici dhe për kujdesin që duhet ta kenë nxënësit në komunikacionin rrugor.

Komandanti i policisë në Junik, Rasim Sylja, ka kërkuar nga nxënësit që të jenë më të

vëmendshëm gjatë kalimit të rrugëve dhe t'i vrojtojnë shenjat e komunikacionit me saktësi në mënyrë që t'u shmangen sa më shumë aksidenteve në trafik. Ndërkaq nxënësit kanë parashtruar pyetje për policët për punën e tyre të përditshme.



Shkëputet kontrata për ndërtimin e shtëpisë së kulturës 'Ukë Bytyçi' në Suharekë



Muharremaj ka theksuar se komuna që drejton do t'i ndërmarrë të gjitha masat ligjore dhe do të vazhdojë me procedurat e reja për këtë projekt, në mënyrë i njëjti të realizohet në afatin sa më të shpejtë.

SUHAREKË, 31 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije se është shkëputur kontrata për ndërtimin e shtëpisë së kulturës "Ukë Bytyçi" në këtë komunë për shkak se operatori ekonomik ka shkelur kushtet e kësaj kontrate. Muharremaj ka theksuar se komuna që drejton do t'i ndërmarrë të gjitha masat ligjore dhe do të vazhdojë me procedurat e reja për këtë projekt, në mënyrë i njëjti të realizohet në afatin sa më të shpejtë. "Përkundër insistimit të Komunës së Suharekës që ky

projekt të realizohet, operatori ekonomik nuk ka treguar gatishmëri për t'i përfunduar punimet sipas kërkesave të autoritetit kontraktues dhe kontratës. Komuna do t'i ndërmarrë të gjitha masat ligjore dhe do t'i vazhdojë procedurat e reja për këtë projekt në mënyrë që i njëjti të realizohet në afatin sa më të shpejtë të mundshëm. Jam i vendosur me sinjeritetin më të madh që ky projekt të realizohet dhe për këtë ju garantoj me angazhimin dhe vullnetin tim", ka thënë Muharremaj.

Përurohët në Kamenicë zyra për intervista me fëmijë dhe kontakte fëmijë - prindër

KAMENICË, 31 MAJ (ER) - Në kuadër të projektit "Përkrahja e Qendrës për Punë Sociale në përmirësimin e shërbimeve në shtëpi dhe ato rezidenciale për fëmijët dhe të rriturit në nevojë", është bërë hapja e zyrës për intervista me fëmijë dhe kontakte fëmijë - prindër te Qendra për Punë Sociale (QPS) në Kamenicë.

Hapja e kësaj zyre do të jetë ndihmesë për komunikimin e fëmijëve me prindërit që tashmë nuk kanë kontakt si pasojë e ndarjes së tyre.

Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka thënë se të gjithë prindërit mund të shihen me fëmijët e tyre dhe t'i shfrytëzojnë ato hapësira së

bashku. "E drejta e kontaktimit të fëmijëve me prindin tjetër është e drejtë e njohur me Ligjin për familje dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe ne po përpiqemi t'u ofrojmë kushte më të mira të gjitha kategorive", ka thënë Kastrati. Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian, bashkëfinancuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, mbështetur nga organizata ndërkombëtare "Save the Children" në bashkëpunim me Qendrën Evropiane për Politika të Mirëqenies Sociale dhe Kërkim dhe është implementuar nga organizata joqeveritare "Network of Peace Movement".



Fëmijët e çerdhes në Malishevë shënojnë Ditën e Fëmijëve

MALISHEVË, 31 MAJ (ER) - Organizuar nga edukatorët dhe fëmijët e çerdhes në Malishevë, të premten është mbajtur një program i shfaqur nga fëmijët e kësaj çerdhe, me rastin e shënimit

të Ditës së Fëmijëve. Në këtë aktivitet ishte i pranishëm edhe i pari i Malishevës, Ragip Begaj, i cili i ka uruar të gjithë fëmijët me rastin e ditës së tyre.

Ditën Ndërkombëtare të

Fëmijëve ua ka uruar edhe drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Blerim Thaçi, ndërsa drejtoresha e çerdhes, Behare Shala, pasi i ka uruar fëmijët, ka folur edhe për të drejtat e fëmijëve.



CIVILIZIMI QË ERDHI NGA MALET



Shkruan: Blerim LATIFI

Karl Popper, me sa di, e thotë diku se nuk duhet t'i hedhim pamenduar idetë, qofshin ato edhe idetë më të marra që dikush mund t'i mendojë. Kjo për arsye se edhe idetë më të çmenduara mund të nxisin të menduarit racional dhe kritik.

Një përvojë të tillë e pata mbrëmë, derisa dëgjoja deklaratën raciste kundër shqiptarëve të kryeministres serbe Ana Brnabiq. Kjo deklaratë më nxiti të mendojë për figurën e malit dhe derisa po mendoja më erdhi një konstatim: racizmi antishqiptar i establismentit të Beogradit nuk

na shpërfaqë vetëm faktin e pafuqisë së Serbisë për t'u shkëputur nga fashizmi i saj kronik, por edhe një fakt tjetër: nivelin e ulët intelektual të klasës aktuale që drejton shtetin serb, emblemë e të cilit është Brnabiq. Secili njeri që ka një minimum edukimi mbi civilizimin njerëzor do të rezervohej të shprehej ashtu, siç u shpreh ajo. Me këtë kam parasysh jo dimensionin moral të deklaratës, sepse ne jemi mësuar tash e 100 vjet të dëgjojmë nga Beogradi deklarata çnjerëzore për ne. Kam parasysh dimensionin intelektual të deklaratës.

Njerëzit e kulturuar, e të edukuar, e dinë se malet nuk janë shenja të barbarisë. Përkundrazi, janë shenja të civilizimit. Njerëzimi historikisht i ka parë malet si vende të shenjta, vende ku njerëzit e kanë ndërë dhe prekur hyjnoren. I gjithë civilizimi antik grek lidhet me figurën e një mali,

me Malin e Olimpët, aty ku kishin fronin perënditë greke. Njërin prej tempujve më të rëndësishëm të besimit të tyre, grekët e kishin ndërtuar në male. Fjala është për Orakullin e Delfit. Hebrejtë, njëri prej tempujve që kishte një ndikim të jashtëzakonshëm në historinë e civilizimit botëror, gjithë kulturën e tij e ka të bazuar mbi figurën e një mali. Është fjala për Malin Sinai, ku, siç besohet, Moisiu u ngjiti për të marrë dhjetë urdhëresat hyjnore. Vetë drama morale e Abrahamit me Zotin zhvillohet në malin Moriah. Predikimi themeltar në historinë e krishterimit quhet "Predikimi i Krishtit në Mal". Edhe vetë fillimet e Islamit lidhen me figurën e malit. Muhametit frymëzimi hyjnor i ndodhi në lartësitë e një mali, në ata që njihet si Mali i Dritës (Jabal an-Nur). Përtej Lindjes së Mesme, tempujt më të rëndësishëm të budizmit janë të vendosur në male. Njëjtë

vepronin edhe popujt e vjetër të Amerikës, para pushtimit evropian. Ndër më të njohurit prej tyre, Inkasit, i vendosin tempujt e tyre në majat më të larta të maleve. Sot nga ajo kulturë ka mbetur tempulli Machu Picchu, në Malet e Andeve në Peru.

Etërit themelues të kombit shqiptar, rilindësit, e njihnin simbolikën e fuqishme të maleve në historinë e civilizimit, prandaj i hyn punës që edhe shqiptarët të kishin figurën e tyre për malin e shenjtë dhe për këtë e zgjodhën Malin e Tomorit në Shqipërinë Jugore. Me këtë rast, Çajupi shkroi: "Baba-Tomor, kish' e Shqipërisë, mal i lartë, fron i perëndisë, tek ti vinin njerëzit që moti për të mësuar se ç'urdhëron Zoti".

Ndërkaq, në Kosovë, filozofi i parë kosovar, Pjetër Bogdani, në veprën e tij "Çeta e Profetëve" e quante Pashtrikun "Mali jonë mbretëror", në kuptimin religjioz

të kësaj fjale.

Shembujt vazhdojnë pafund, sepse kudo që është shfaqur një formë e kulturës shpirtërore të njerëzimit, aty kemi edhe figurën e një mali. Dhe, nëse ka ndonjë gjë e kanë të përbashkët të gjitha kulturat, ajo gjë është ideja mbi shenjtësinë e maleve. Natyrisht, Brnabiq nuk e ka parasysh këtë fakt, sepse në fashizmin e saj kronik e shenjtë është vetëm Kosova, aty ku serbët gjithmonë kanë bërë vetëm gjëra të pashenjta, krime e gjenocid kundër popullit shqiptar, dhe të cilat kurrë më nuk do të kenë rast t'i përsërisin. Sa t' nxen dielli, e t'rrezon hana, do të thoshte Gjergj Fishta.

Në fund të refleksionit tim, për desert, mu kujtua shkrimtari i madh amerikan, Ernest Heminguej, i cili thoshte se ekziston vetëm një sport, e ai është ngjitja në male. Të tjerat janë thjesht lojëra.

Ministri Bytyqi: Presim rezultate të mira nga testi i arritshmërisë

KAÇANIK, 31 MAJ (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka vizituar të premten Gjimnazin 'Skënderbeu' në Kaçanik, në të cilin po mbahej testi i arritshmërisë me nxënësit e klasave të nënta të kësaj komune. Me këtë rast, ministri i shoqëruar nga kryetari i komunës, Besim Ilazi, kanë takuar Këshillin Drejtues të këtij gjimnazi, me të cilin kanë biseduar rreth mbarëvajtjes së procesit mësimor në këtë institucion dhe për zhvillimet në arsim në Komunën e Kaçanikut. Në këtë takim ministri Bytyqi ka shprehur përkrahjen e Ministrisë së Arsimit për sigurimin e ambienteve të përshtatshme për fëmijët tanë dhe motivimin e mësimit, duke ofruar ambiente të përshtatshme për mësimit. "Nga vizitat që po i bëjmë në shkolla jo vetëm se po shohim se si po mbahet testi i arritshmërisë, por bashkë me drejtorin dhe drejtuesit lokalë po diskutojmë për punën e mësimit tanë. Pra, vetëm kur fillon debati dhe diskutimi mund të shihet se sa kemi nevojë që



niveli qendror dhe niveli lokal, bashkë me mësimit, të diskutojmë për sistemin arsimor si dhe për nevojat që kanë shkollat", ka thënë ministri Bytyqi.

Ministri Bytyqi tha se testi i

arritshmërisë është një mundësi e mirë që nxënësit të dëshmojnë të arriturat e tyre gjatë shkollimit fillor dhe të mesëm të ulët, ndërsa tha se pret rezultate të mira nga ky test. Ministri Bytyqi të

premtën ka vizituar edhe Shkollën Filllore "Idriz Seferi" ku, po ashtu, takoi Këshillin Drejtues të shkollës, me ç'rast shprehu përkrahjen e Ministrisë së Arsimit për të krijuar kushte dhe ambient të

mirë në shkolla. Në këtë shkollë ministri pati rastin që për disa çaste të qëndrojë me fëmijët parashkollorë të cilët kishin përgatitur një program të shkurtër artistik për ta shënuar festën "1 Qershori".

Rektori Temaj nderon viktimat e Holokaustit

PRIZREN, 31 MAJ (ER) - Rektori i Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, prof. asoc. dr. Ismet Temaj, i shoqëruar nga anëtarët e Këshillit Drejtues,

prof. ass. dr. Artan Nimani dhe prof. ass. dr. Ylli Kortoci, kanë vizituar kampin famëkeq të përqendrimit në Poloni, në nderim të vikti-

mave në përvjetorin e mbylljes. Kampi i përqendrimit në Auschwitz ishte një rrjet kampesh naziste të përqendrimit

dhe kampeve të shfarosjes të ndërtuara dhe të operuara nga Rajhu i Tretë në zonat polake, aneksuar nga nazistët gjatë Luftës së Dytë Botërore.



Shtohet numri i pretendentëve për pasardhës të Theresa May

LONDËR, 31 MAJ - Pretendentët për ta pasuar kryeministren britanike Theresa May arritën në 12, pas njoftimit të premtën të kandidatës së Mark Harper, një deputet konservator, i cili votoi pro qëndrimin të vendit në BE më 2016.

Në pamundësi të zbatimit të Brexitit, planifikuar më 29 mars, por që është shtyrë më 31 tetor ose edhe për më vonë, liderja konservatore njoftoi të premtën e kaluar për dorëheqje. Ajo do t'i lërë funksionet më 7 qershor, por do ta ndërmjetësojë periudhën transitore derisa 100 000 anëtarët

e partisë së saj të zgjedhin, deri më 20 korrik, pasuesin e saj. Sipas "Daily Telegraph", Mark Harper, 49 vjeç, është i vetmi nga 12 kandidatët që nuk ka qenë pjesë e kabinetit qeverisës së Theresa May. "Ne kemi parë të njëjtët persona të thonë të njëjtat gjëra këta tre vjet", pohon ai për të përditshmen konservatore.

Deputeti, një figurë pak e njohur për publikun, kritikon faktin se disa kandidatë në garë, duke nisur nga kandidatura më favorite Boris Johnson janë shumë pro një Brexit pa marrëveshje më 31 tetor. "Ky skenar do të kishte

pasoja të rënda për biznesin dhe ekonominë", thotë ai.

Çështja e Brexitit po luan një rol kyç në garën e pasuesit të Mayt. Liderja do t'i lërë në fakt zëvendësuesit të saj detyrën e rëndë të zbatimit për largimin nga BE-ja, në një shtet me qëndrime të kundërta për çështjen ose në përpjekje për të negociuar një marrëveshje të re me Brukselin, i cili deri më tani kundërshton në mënyrë kategorike një mundësi të tillë, ose opsionin për një dalje pa marrëveshje.

Zvarritjet kohore për Brexitin i kushtuan shtrenjtë Partisë



Konservatore, që e mbylli me një vend të pestë poshtërues në zgjedhjet evropiane, javën e kaluar, me vetëm 9% të votave.

ShBA-ja sërish paralajmëron Turqinë lidhur me raketat ruse S400

Ndihmësekretarja amerikane e Mbrojtjes, Kathryn Wheelbarger, tha se blerja e sistemit të raketave S-400 nga ana e Turqisë do të kishte një efekt "shkatërrues" për raportet e saj me aleatët e tjerë të NATO-s si dhe pjesëmarrjen e saj në programin e furnizimit me aeroplanë luftarakë të ShBA-së, F-35

UASHINGTON, 31 MAJ - Një zyrtare e lartë e Pentagonit ka paralajmëruar përsëri Turqinë për pasojat e blerjes së një sistemi të mbrojtjes raketore nga Rusia. Presioni i fundit amerikan ndaj Turqisë bëhet pavarësisht prej vendosmërisë së deklaruar të Ankarasë për ta realizuar marrëveshjen me rusët.

Ndihmësekretarja amerikane e Mbrojtjes, Kathryn Wheelbarger, tha se blerja e sistemit të raketave S-400 nga ana e Turqisë do të kishte një efekt "shkatërrues" për raportet e saj me aleatët e tjerë të NATO-s si dhe pjesëmarrjen e saj në programin e furnizimit me aeroplanë luftarakë të ShBA-së, F-35. "Përfundimi i këtij transaksioni do të ishte shkatërrues jo vetëm për programin F-35, në të cilin Perëndimi ka integruar aftësinë ajrore të modernizuar të saj, por kjo do të mund ta shkëpuste ndërveprimin turk me NATO-n, një aspekt kyç i mbrojtjes së aleancës", tha Wheelbarger gjatë

një fjalimi në Këshillin Atlantik në Uashington. "Le të jetë e qartë, S-400 është një sistem rus i projektuar për të rrëzuar një avion si F-35, dhe është e pakonceptueshme të imagjinohet se Rusia nuk përfiton nga kjo marrëveshje me Turqinë", shtoi ajo. Zyrtarja e lartë amerikane tërhoqi vërejtjen se nëse ky sistem rus integrohet në ndonjë vend aleat të NATO-s, atëherë kjo e minon aftësinë e ShBA-së për t'i ndihmuar këto vende të mbrojnë veten e tyre.

Turqia, si anëtare e NATO-s, po merr pjesë në prodhimin e avionit luftarak amerikan për përdorim nga ushtarët e aleancës dhe ka në plan vetë t'i blejë 100 avionë luftarakë nga ShBA-ja. Por, Shtetet e Bashkuara kanë kërkuar që Ankaraja të heqë dorë nga marrëveshja për blerjen e sistemit rus dhe aleatët e NATO-s, gjithashtu kanë shprehur shqetësime rreth kërcënimit të mundshëm që ky sistem paraqet



për avionët luftarakë të prodhuar nga ShBA-ja.

Uashingtoni ka paralajmëruar Ankarën se mund të përballet me sanksione nëse Turqia e vazhdon marrëveshjen me rusët. Zyrtarët e ShBA-së kanë thënë,

po ashtu, se kompanitë turke do të eliminohen nga puna e prodhimit që lidhet me programin e avionëve F-35.

Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan ka refuzuar të marrë në konsideratë anulimin e blerjes së

raketave dhe e ka quajtur atë një "marrëveshje të kryer". Ndërkaq, ministri i Mbrojtjes i Turqisë, Hulusi Akar, ka thënë së fundmi se Turqia ka dërguar tashmë personel në Rusi për trajnimin në sistemin e raketave.

Në Iran dhe vende të tjera shënohet Dita e Jerusalemit

TEHERAN, 31 MAJ - Në gjithë Iranin u mbajtën të premtën tubime për ta shënuar Ditën e Jerusalemit apo, siç njihet atje, Kuds. Irani e shpalli këtë ditë pas Revolucionit Islamik të vitit 1979, si një rast për ta shprehur mbështetjen për popullin palestinez, ndërsa demonstratat e mbështetura nga shteti zakonisht shprehin revoltë kundër Shteteve të Bashkuara dhe Izraelit.

Tubime u mbajtën në rreth 950 qytete të Iranit, në Irak, në Liban

dhe gjetkë.

Ngjarja këtë vit ndodh në kohën kur administrata e presidentit amerikan, Donald Trump, pritet të dalë me një plan për zgjidhjen e konfliktit izraelit-palestinez.

Shtëpia e Bardhë ka thirrur një takim rajonal më 25 dhe 26 qershor në Bahrejn. Plani pritet të fokusohet në investimet dhe zhvillimin e infrastrukturës në territoret palestineze, me fonde që vijnë kryesisht nga vendet arabe.

Zyrtarët palestinezë kanë thënë

se nuk do ta ndjekin konferencën në Bahrejn, pasi krijimi i shtetit palestinez, statusi i qytetit të kontestueshëm të Jerusalemit dhe çështje të tjera nuk janë në agjendë.

Izraeli, tash e sa dekada, është në konflikt me palestinezët. Të dyja palët e duan territorin e njëjtë dhe gjetja e kompromisit ka dalë të jetë e vështirë.

Irani nuk e njeh Izraelin dhe siguron mbështetje për grupet anti-izraelite, Hamasin and Hezbollahun.





BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.



E rrallë

Parku me qindra statuja që duket si në përrallë

Gjatë jetës së tij, Veijo Ronkkonen ka ndërtuar një park të jashtëzakonshëm në Koitsanlahti, Parikkala, pranë kufirit rus në Finlandë. Ai ka punuar atje për pothuajse 50 vjet. Puna e tij e kryer në një sipërfaqe prej rreth gjysmë hektarësh, prodhoi rreth 560 statuja betoni dhe një kopsht madhështor.



FOTO E DITES



Një pyll në Mongolian është emërtuar "Pylli i çuditshëm" pas formave të çuditshme të drurëve të vdekur. /Foto: The Guardian/

E jashtëzakonshme

Varri misterioz në Irlandë, më i vjetër se piramidat

Kompleksi i Njugrejnxhit është ndërtuar rreth 3200 vjet para erës sonë. Megjithatë, njerëzit modernë e zbuluan vetëm në vitin 1699, kur një pronar toke donte të bënte gërmime për të nxjerrë gurë. Bëhet fjalë për një strukturë rrethore, me një tunel prej guri brenda dhe me dhoma anash. Arkeologët e kanë quajtur si



"varr kalimi". Shumica e mbetjeve njerëzore janë trupa të djegur dhe pranë tyre kanë gjetur sfera prej guri, në formë dekorimi, si dhe rruaza.

BARSOLETA E DITËS



- Doktor, sot i kam pirë barnat në orën 15:15.
- Unë të kam thënë t'i pish në orën 17:45.
- E di, po desha t'ua bëj një surprizë mikrobeve.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit ne ora 14:00

"DUMBO" 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min

Rolet: Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.
Regjia: Tim Burton



Ne ora 16:00 dhe 19:00

"AVENGERS; Endgame"

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlett Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.
Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 20:00

"EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE"

Krim/Mister; 1 ore 48 min

Rolet: Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.
Regjia: Joe Berlinger



16.05.2019

"THE HUSTLE"

Komedi

Rolet: Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

Regjia: Chris Addison



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Po të ktheheni pas në kohë do t'i kuptoni gabimet që keni bërë. Gjithçka do të kishte marrë tjetër drejtim nëse kishit pak më tepër vëmendje.</p>	 <p>DEMI Nga një takim i sotëm do të merrni me vete ato gjëra që janë të nevojshme dhe do të neglizhoni gjithçka tjetër.</p>	 <p>BINJAKËT Jeni mjaft racional sot dhe nuk do të fluturoni veç nga një fjalë e thënë. Do të analizoni me kujdes çdo gjë që do t'ju shtrohet për marrëveshje.</p>	 <p>GAFORRJA Sot do të pushtoheni nga ëndrra romantike dhe do të përjetoni një çast gëzimi pranë personit të zemrës. Surpriza e bërë nga partneri do t'ju kënaqë.</p>	 <p>LUANI Edhe pse sot do të merrni kritika, këto nuk do t'ju stepin në hapat që keni ndërmarrë. Do ta vazhdoni qetë dhe bindur rrugën e nisur.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Keni themele të forta në një bashkëpunim në fushën profesionale dhe nuk do t'i prishë aspak një debat që do të bëhet ditën e sotme.</p>
 <p>PESHORJA Çdo situatë sot do të jetë mjaft me tension dhe ju ndiheni sikur gjithë bota e ka me ju. Do të keni luhatje të mëdha humori.</p>	 <p>AKREPI Jeni fjalëpakë, por veprat tuaja janë të mëdha. Po bëni shumë për familjen. Duhet të fokusoheni edhe më shumë kah biznesi.</p>	 <p>SHIGJETARI Sot keni tendencën të thoni disa gënjeshtër të vogla për të mos u përballur me përgjegjshmërinë tuaj karshi një ngjarje të caktuar.</p>	 <p>BRICJAPI Do t'ju duhet të qëndroni me këmbë në tokë dhe të mos bini pre e asnjë fantazie sepse situata në të cilën gjendeni nuk jua lejon këtë gjë.</p>	 <p>UJORI Një ditë disi e vështirë për të tjerët, por jo për ju. Jeni armatosur me mjaft pozitivitet dhe energji që në mëngjes dhe kjo ju bën solar.</p>	 <p>PESHQIT Nuk jeni ende gati për të bërë disa zgjedhje që do të kondiciononin të ardhmen tuaj. Doni të fitoni edhe pak kohë.</p>

Bebe Rexha vjen me këngë të re



Këngëtarja e njohur me prejardhje nga Shqipëria, Bebe Rexha, ka paralajmëruar adhuruesit se shumë shpejt do ta publikojë këngën më të re. Kjo këngë e Rexhës quhet "Call You Mine", por ende nuk dihet

koha e saktë se kur do të publikohet. Këtë e bërë me dije vetë këngëtarja me anë të një postimi në rrjetin social "Facebook". Rexha në këtë postim ka edhe një video ku është një pjesë e shkurtër e këngës.

Selena Gomez kthehet në vitet '90



Trendi i modës të viteve '90 po rikthehet. Të paktën këtë po e bën Selena Gomez, e cila ka rikrijuar një veshje të cilën më parë e kishte veshur Jennifer Anistoni. Gomez është fotografuar nga paparacët derisa po shëtiste

me një veshje që na ka bërë të gjithëve të sigurohemi nëse jemi duke parë mirë. Ajo kishte veshur një palë pantallona të ngjitura me ngjyrë të zezë me një bluzë të bardhë poshtë tyre dhe atlete, po ashtu të bardha.



E dashura e Ronaldos shfaq trupin seksi në një mbrëmje glamuroze në Madrid

Georgina Rodriguez, e dashura e futbollistit të njohur Cristiano Ronaldo, e ka marrë të gjithë vëmendjen teksa është shfaqur në një mbrëmje glamuroze të Elle

Galaxy në Madrid. 25-vjeçarja dukej tejet në formë e veshur me një fustan ngjyrë ari. Përveç veshjes, Rodriguez ishte kujdesur që edhe grimi i saj të jetë i bukur dhe i pastër.

Tove Lo po vjen me gjëra të reja



Tove Lo po bëhet gati ta publikojë albumin e ri. Këngëtarja 31-vjeçare nga Suedia sapo ua dhuroi fansave këngën e re "Glad He's Gone", e cila është e para nga albumi i

saj i ardhshëm. Tove Lo do ta publikojë albumin në fund të vitit dhe fansat dyshojnë se do të titullohet "Sunshine Kitty". Ndërkaq, albumi "Blue Lips" i saj ishte publikuar në nëntor të vitit 2017.

Pianistja shqiptare trondit Uashingtonin, zbulohet karriera dhe miqtë



Të bësh karrierë në muzikë klasike është një rrugë e vështirë. Ky rrugëtim bëhet edhe më sfidues kur ndodhesh në vend të huaj. Por Merzana Kostreci me punën dhe talentin e saj, po mahnit publikun me lojën e saj në piano. Artistja shqiptare, po bën karrierë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke synuar që të bëhet një emër i njohur i muzikës klasike. Karrigia pranë pianos është vendi më i rehatshëm për të, ndërsa tingujt e këtij instrumenti muzikor janë arma e saj më e fortë. Artistja shqiptare Merzana Kostreci, po bën karrierë si pianiste në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, një ëndërr të cilën e ka qysh nga fëmijëria. “Unë e kam nisur pianon që e vogël dhe kam vite që performoj për publikun. Jo vetëm që është e veçantë për mua, sepse mua më pëlqejnë të gjitha llojet e muzikes, por kur luaj muzikë klasike, piano për mua është si një pjesë e imja. Performanca në piano dhe pjesët kur unë luaj për publikun, shprehin atë që mund

të ndjej dhe nuk e them dot me fjalë. Kënaqësia më e madhe është kur edhe publiku e pëlqen performancën dhe unë arrij të përcjell ndjenjat e mija nëpërmjet muzikës tek publiku”, thotë Merzana. Pianistja Kostreci deri tani ka realizuar disa performanca në Evropë e SHBA. Çmimet artistike të fituara në Shqipëri, i mundësuan asaj shkollimin në Universitetin e Muzikës në Këln të Gjermanisë. Por diplomimi në vitin 2003 duket nuk i mjaftoi Merzanës... Ajo vazhdoi studimet për piano në Universitetin e Maryland-it, në Shtetet e Bashkuara. “Sfida që kam hasur unë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si vend i huaj së pari, ka qenë sepse nuk është vendi ku ke lindur dhe do pak kohë që të krijosh një reputacion si muzikante. Gjithashtu kam pasur vështirësi si muzikante klasike, sepse këtu ka nga të gjitha llojet e rrymave të muzikës që konkurrojnë për të patur një treg, për t’u bërë të

suksesshëm”, thotë Merzana. “Pjesët që kam zgjedhur për këtë recital janë kryesisht pjesë të stilit romantik. Kam katër pjesë nga Chopin. Pjesët nga Chopin janë intime në përgjithësi dhe i kam zgjedhur tamam për sezonin e pranverës. Gjithashtu kam një pjesë nga Shuman, që është një pjesë më virtuozë. Gjithmonë kam qejf të kem pjesë virtuozë në repertor, sepse janë më ritmike dhe më të gjalla”, thotë ajo. Interpretimin e saj e shoqëruan duartrokitjet e gjata. Nuk munguan as lëvdatat për artisten Kostreci, nga publiku që u largua nga shfaqja me përshtypje dhe ndjenja pozitive. “Kjo paraqitje i ka tejkaluar pritjet e mija. Unë kuptoj shumë nga muzika klasike dhe pashë një performancë të mirë. Kjo shfaqje po më kujton fjalët e një muzikanti profesionist, që thoshte se performanca të këtij niveli nuk arrihen nga ato që ke lexuar dhe ke mbajtur mend, jo ajo që është në duart, mendjen dhe në shpirtin e një artisti.

Prandaj kjo artiste mori duartrokitje më se të merituar. Për mua është privilegj të jem këtu dhe e falenderoj për këtë”, thotë David Pappert, banor i Uashingtonit dhe ish-drejtor i Bordit të Drejtorëve të Universitetit Duquesne. “Ne u kenaqëm shumë sonte. Merzana na mbajti pezull me muzikën e vet. Ishte kënaqësi jo vetëm për faktin që ti shkon diku në një salle koncerti, muziken e veçantë për të mbështetur njëri tjetrin, për të mbështetur pikërisht artistët e rinj, talentet e reja, nxënësit, studentët të cilët performojnë kudo ku ata janë. Ishte kënaqësi shumë e madhe”, thotë banorja e Uashingtonit Enkelejda Balliu. “Mendoj se ajo është shumë e talentuar, luan me pasion. Jam e mahnitur nga fuqia e saj. Jam e impresionuar nga pjesët e luajtura nga ajo. Shpresoj që ajo të ketë karrierë të mrekullueshme. Ajo duhet të vazhdojë të luajë profesionalisht dhe të vazhdojë ta rrisë audiencën e saj, sepse e

meriton të njihet. Ajo është një pianiste e mrekullueshme”, thotë Caren Ginsberg. “Koncerti që sapo ndoqëm ishte me të vërtetë shumë i arritur nga ana artistike dhe teknike. Meri Kostreci është shumë e talentuar dhe të gjitha veprat që luajti ajo sot, ishin jo vetëm të bukura, por kishin të gjithë spektrin e emocioneve, nga ato romantike tek ato më të fuqishme. Për sa i përket aktiviteteve kulturore në zonën tonë është një gjë që të jep kënaqësi të jashtëzakonshme që të kesh një aktivitet si ky që e ndoqëm”, thotë Evi Budo Struble. Merzana Kostrecin e pret një rrugë e gjatë drejt synimeve të saj, por ajo premton se nuk do të ndalet në rrugëtimin drejt suksesit, krahas punës së përditshme që bën si mësuese pianoje. Kjo ishte hera e tretë që ajo interpretoi e vetme. E veçanta e këtij recitali është se të gjitha pjesët e luajtura, i ka përgatitur vetë. Herën tjetër ajo synon t’i sjellë para publikut tingujt e saj, në një koncert me orkestrë.

Ja dhurata e veçantë që Hitleri kishte për Mbretin Zog; Musolini prish planin



La Charente" ka botuar, të hënën e 19 qershorit 1939, në faqen n°2, një shkrim në lidhje me fatin e kurorës së Skënderbeut, të cilin Aurenc Bebja, nëpërmjet Blogut "Dars (Klos), Mat - Albania", e ka sjellë për publikun shqiptar: Musolini i kërkoi Hitlerit kurorën e vërtetë të mbretërve të Shqipërisë që gjendet në

Gjermani "Mes shumë bizhuterive që nazistët, pas Anschluss-it, gjetën në Vjenë, bën pjesë edhe kurora unike dhe e vërtetë e Shqipërisë, të cilën Hitleri e ka transportuar tashmë në Gjermani. Vitin e kaluar, me rastin dhjetë vjetorit (jubileut) të mbretit Zog, Hitleri kishte përgatitur gjithç-

ka, për t'i "dhuruar" këtë kurorë. Por Musolini, i cili padyshim kishte idenë e tij, kërkoi të shtyjë këtë operacion, dhe Zogu nuk e mori kurorën e tij të vërtetë. Disa javë më parë, Italia kërkoi nga Fyhreri që t'i dërgonte emblemat shqiptare mbretit Viktor Emanuel, në mënyrë që kurorëzimi të bëhej me të gjithë shkëlqimin e dëshiruar."



Në kërkim të azilit, nga modele në Iran në endacake në Paris

Trupi i saj i përsosur mund t'i kushtonte asaj jetën: kështu Neguzia (një emër i bukur që zgjodhi për të mbrojtur veten) vendosi të largohet nga Irani dhe të kërkojë mbrojtje në Francë. Faji i saj? Duke qenë një modele e suksesshme në Teheran: në vendin e ajatollahëve, ata që punojnë në botën e modës akuzohen për përhapjen e "një kulture anti-islame" dhe për këtë meriton burg. Nëse gjithçka shkon mirë.

Kështu, 29 vjeçe, pasi u kontaktua nga agentët e "policisë për virtyte" për disa fotografi të guximshme të publikuara në profilin e saj Instagram, ajo vendos të ikë. Ishte viti 2017 dhe vetëm sot ajo del dhe tregon historinë e saj për "Le Parisien". Një histori guximi, frike, vështirësie: e kërcënuar, e grabitur, e detyruar të jetojë në rrugë për muaj të tërë. Pas një qëndrimi të shkurtër në Stamboll, ajo arrin të bëjë hapin e madh duke shkruar në Paris në 2018-ën.

U dashurua me Francën dhe në



nëntor paraqiti kërkesën për azil politik. Vetëm kohët nuk janë të

shpejta. Dhe në të njëjtën kohë kursimet i përfundojnë. Ajo fil-

lon të jetojë si një endacake, shet çantën me rrobat e saj për

10 euro, merr strehë nga disa njerëz të pastrehë që e mbrojnë nga rreziqet dhe i ofrojnë asaj batanije për t'u ngrohur. Një jetë e vështirë për muaj. Gjatë ditës, kërkon vende të ngrohta për të marrë strehim dhe për të marrë një sinjal wi-fi për të mbijetuar në llogarinë e saj në Instagram.

Historia e saj godet një avokat, i lindur në Francë, por me origjinë iraniane, i cili vendos të ndjekë praktikën e Neguzisë. Tani ajo që duhet të bëjë është pritja dhe shpresa: jurisprudenca e fundit e Gjykatës Kombëtare të Azilkërkuesve (CNDA) i konsideron gratë viktimat të persekutimit për shkak të kushteve të tyre.

Kjo gjithashtu mund të favorizojë Neguzinë, por të paktën tre muaj duhet të kalojnë për pranimin e kërkesës së saj për azil. Por ajo nuk heq dorë: "Nuk mund të kthehem në vendin tim pa rrezikuar jetën time, nuk kam asgjë për të humbur".

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"

TEL: 045 82 82 82

MKRS-ja mbështet fuqishëm sportin dhe trashëgiminë në Prizren

MKRS-ja në dhjetë memorandumet e nënshkuara me Komunën e Prizrenit do të investojë në sport një shumë prej 3.6 milionë eurosh, kurse pjesa tjetër tre milionë të trashëgimia kulturore



PRISHTINË, 31 MAJ - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka nënshkruar 10 memorandumet me Komunën e Prizrenit, të cilat i nënshkruan ministri Kujtim Gashi dhe kryetari Mytaher Haskuka. Projektet në të cilat MKRS-ja do të investojë janë "Pishina Olimprike, Prizren" 1 milion e 350 mijë euro për tre vjet; "Ndërtimi i Stadiumit në Zhur, Prizren" 1 milion euro për tre vjet; "Stadiumi Përparim Thaqi, Prizren" 840 mijë euro; "Fusha Sportive në Lubinj të Epërme - Prizren" 120 mijë euro; "Stadiumi i fshatit Gjonaj - Prizren" 100 mijë euro; "Poligoni Sportiv në Mushnikovë - Prizren", 60 mijë euro; "Ndërtimi i Qendrës Kulturore në Novo Selo në Prizren" 50 mijë euro; "Ndërtimi i Qendrës Kulturore në Pausë në Prizren" 50 mijë euro; "Ndërtimi i Qendrës Kulturore në Skorrobisht në Prizren" 50 mijë euro; dhe "Kompleksi sportiv "11 Marsi", Prizren" 50 mijë euro. Ministri Gashi ka thënë se projektet në të cilat do të investojë MKRS-ja janë mbështetje në kuadër të politikave dhe programit të ministrisë dhe se pret që pas realizimit të projekteve do të krijohen mundësi të jashtëzakonshme për qytetarët ashtu që ata ta kenë më të lehtë t'i kryejnë aktivitetet kulturore e sportive. Ministri sqaroi se një pjesë e vogël e projekteve janë vazhdimësi e viteve të kaluara, ndërsa pjesa më e madhe e projekteve janë projekte të reja që MKRS-ja do të investojë në

Prizren. "Një shumë prej 3.6 milionë eurosh janë fokusuar te pjesa e sportit pa e llogaritur pjesën tjetër 3 milionë të trashëgimia kulturore. Pra, ministria është e fokusuar në fushën e trashëgimisë kulturore në qytetin e Prizrenit, meqenëse është qytet që ngërthen në vete një pjesë të madhe të monumenteve dhe të aseteve. E shfrytëzova këtë mundësi për të kërkuar përkushtim më të madh prej komunës te projektet e reja. Ne kemi projekt të përbashkët me UEFA-n, kemi edhe 12 stadiumet ndihmese dhe aktualisht Prizreni nuk ka një hapësirë të cilën do të na e siguronte për fillimin e ndërtimit të këtij projekti, pra për të pasur edhe një stadium ndihmës në qytetin e Prizrenit, megjithatë jemi pajtuar që mundësia për një stadium ndihmës të jetë në Gjonaj, meqë edhe aty kemi një klub aktiv dhe kemi një hapësirë por, gjithashtu, për disa ditë do të kemi edhe stadiumin ndihmës në Boka, investim i MKRS-së", ka thënë Gashi, i cili ka treguar se do ta vizitojë edhe stadiumin e qytetit dhe pishinën olimprike ku po kryhen punimet për të inspektuar ato. "Jam i interesuar që stadiumi 'Përparim Thaqi' të përfundojë këtë vit që klubeve tona t'i krijohen mundësi të reja edhe për shfrytëzim dhe për zhvillimin e lojërave", ka shtuar ministri Gashi. "Prizreni ka vëmendjen time të shtuar për ta avancuar infrastrukturën dhe këto memorandumet do të jenë mundësi e mirë

dhe e re për sportdashësit dhe njerëzit e kulturës. Me këto projekte jemi shtrirë në pjesën e Hasit, Lumbardhit dhe në të gjitha pjesët e Prizrenit", ka deklaruar ministri Gashi. Ndërsa kryetari Haskuka shprehu falënderimin për mbështetjen nga ana e MKRS-së dhe e ministrit Gashi për projektet në fjalë. "Duhet punë më shumë lidhur me çështjen e hapësirave ku duhet t'i bëj këto projekte. Po besoj se edhe me ligjin e ri do të kemi mbështetjen e ministrit dhe do të kalojë më shpejt në qeveri. Biseduam edhe për projekte të reja. Falënderojmë ministrin për gatishmërinë dhe mbështetjen. Besoj se me këto vendime Prizreni të bëhet qytet i kulturës dhe sportit", është shprehur Haskuka. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për këtë vit ka investuar qindra mijëra euro në projekte të trashëgimisë, me theks rehabilitimin dhe restaurimin e objekteve në rrugën "Marin Barleti" në Prizren. "Shumë shpejt do të fillojnë edhe punimet në rrugën 'Marin Barleti'. Është një projekt tashmë i finalizuar dhe shumë shpejt do ta fillojmë restaurimin e të gjitha atyre shtëpive që gjenden në këtë rrugë, ku në fazën e parë të projektit janë të përfshira 14 shtëpi", ka njoftuar ministri Gashi. Ministri e ka njoftuar kryetarin Haskuka që ministria ka marrë vendim që në qytetin e Prizrenit t'i ngritët shtatorja e kongresmenit Eliot Engell.

SHKURT

Feronikeli 'blindon' Hoxhën

Skuadra e Feronikelit, pas triumfit në garën për titull dhe Kupë, sot ka arritur marrëveshje për vazhdimin e kontratës me futbollistin Yll Hoxha. "Nikli" ka njoftuar se futbollisti prishtinas ka rinovuar kontratën edhe për dy sezonet e ardhshme. "Pas një takimi me presidentin Naser Ramaj, Hoxha ka nënshkruar kontratën e re, që do ta mbajë në klub edhe për dy sezonet e ardhshme. Ai iu bashkua klubit në fund të vitit 2016, duke treguar paraqitje fantastike që nga atëherë. Yll Hoxha është nënshkrimi i parë për sezonin e ardhshëm, nga shumë të tjera që pritet të vijnë në ditët e ardhshme", thuhet në njoftimin e KF Feronikeli.

Shaqiri, trajner i Flamurtarit

Flamurtari i Prishtinës e ka emëruar trajner të ri ish-futbollistin e Premierë Ligës angleze, Artim Shaqirin. Lajmin e ka konfirmuar për "Olle", Imer Ademi, kryetar i KF Flamurtari. Shaqiri që është nga Maqedonia, si trajner ka drejtuar edhe Kukësin e Shkëndijën e Tetovës. Ndërsa si futbollist ka luajtur në Liga të ndryshme të Evropës, kurse kulmin e arriti kur veshi fanellën e West Bromwich Albion.

Jep dorëheqje e tërë udhëheqja e Fushë-Kosovës

KF Fushë-Kosova u dënua nga komisionet e FFK-së me heqjen e nëntë pikëve, me ç'rast u dëbua në Ligën e Dytë. "Pas analizimit të këtij stinori dhe vendimeve të njëanshme të komisioneve të FFK-së, japim dorëheqje të paravokueshme nga postet drejtuese të klubit futbollistik Fushë-Kosova. Dorëheqja vjen nga presidenti, bordi dhe stafi teknik. Falënderim i veçantë për lojtarët dhe tifozët 'Pampurat' që na përkrahen gjatë gjithë kohës", thuhet në njoftimin e KF Fushë-Kosova.

Golden State befasohet nga Toronto

Oakland, 31 maj - Finalja e madhe e kampionatit amerikan të basketbollit, NBA, ka nisur menjëherë me një befasi. Kanadezët e Toronto Raptorsit u janë imponuar 118-109 kampionëve në fuqi të Golden States në "Air Canada Centre", duke siguruar kështu fitoren e parë në historinë e tyre në një finale të madhe. Skuadra e drejtuar nga Nick Nurse kontrolloi ndeshjen që nga fillimi falë edhe mbrëmjes së magjishme të Pascal Siakamit, që shënoi 32 pikë, ndërkohë që "Warriors"-at e privuar nga Kevin Durant nuk e panë të mjaftueshëm kontributin prej 34 pikësh të Stephen Curryt. E nëse vlen shprehja se "dita e mirë duket që në mëngjes", atëherë sfidat në mes të Torontos dhe Golden States me siguri do të jenë një seri e destinuar të dhurojë emocione të forta e, ndoshta, edhe rezultate surprizë. Në "Air Canada Centre", kanadezët, që militojnë në basketbollin amerikan, patën mbështetjen e fuqishme të rreth 20 mijë spektatorëve jo vetëm për shkak se ky është sezoni i dytë që Raptorsi pretendon bindshëm, por edhe sepse përballë kishte kampionët e dyfishtë në fuqi të NBA-s.

Haradinaj ia dhuron Mazrekajt flamurin kombëtar para përballjes me boksierin serb

PRISHTINË, 31 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, e ka prituri të premtën në takim boksierin me prejardhje nga Kosova, Petrit Mazrekaj.

Haradinaj ia ka dhuruar boksierit Mazrekaj flamurin kombëtar dhe i ka uruar suksese në meçin e radhës ndaj boksierit serb Vekjko Raznatoviç. "Prita boksierin

Petrit Mazrekaj, të cilit i urova shumë suksese në meçin e radhës. Petriti ka shpirt sportisti, por si shqiptar e ka edhe një motiv shtesë në përballjen e

tij. Për motivim si dhe evokim se cila ishte rruga jonë deri në liri, ia dhurova atij flamurin kombëtar!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".



Tottenhami dhe Liverpooli kërkojnë trofeun e Ligës së Kampionëve



LONDËR, 31 MAJ - Dy klubet angleze, Tottenham Hotspur dhe Liverpool, besojnë se sonte (e shtunë) mund të triumfojnë në Ligën e Kampionëve, pasi në rrugëtimin e tyre deri në final nuk kanë munguar dramet dhe befasishtë e mëdha. Të dy këto klube më shumë mund kanë arritur deri në finalen e Madridit, kurse në ditët e fundit ka mbretëruar një qetësi absolute në të dy kampet. Nuk mbahet mend në histori të futbollit që dy klube finalistë kanë arritur deri në këtë pikë në mënyrë kaq të vështirë. Liverpooli pasi e humbi finalen e vitit të kaluar ndaj Real

Madridit dhe në këtë edicion titullin në Premier Ligë për një pikë, janë mobilizuar për ta fituar Ligën e Kampionëve.

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, ka thënë para finales se është shumë vështirë të parashikohet favoriti në këtë finale. "Do të jetë një finale shumë intensive. Favoriti? E vështirë ta thuash. Kemi fituar dy ndeshje kundër tyre, me shifrat 2-1. Do të doja të bënim sërish atë që bëmë me Barcelonën. Tottenhami është një ekip i fortë dhe ka shumë kualitet. Gjithçka do të varet edhe nga klima, duket se do të jetë nxehtë dhe do të ndikojë te

ne", ka thënë Klopp, duke shtuar: "Që nga viti 2012, përveç vitit 2017, kam qenë në një finale me ekipin që kam drejtuar. Ndonjëherë me fat, por në shtatë vjetët e fundit mbaj rekord për gjysmëfinalen e fituara. Edhe unë njeri normal jam. Ka çaste që je me fat dhe që nuk ke, por nuk e ndryshoj dot këtë. Nëse punën, edhe fatin do ta kesh me vete herë pas here".

Lajm i mirë për Liverpoolin është rikthimi i Roberto Firminos, kurse mungon mesfushori Naby Keita. Në anën tjetër, Tottenhami do të ketë në dispozicion Harry Kanen dhe Harry Winksin.

Ramadani publikon listën për ndeshjet ndaj Polonisë dhe Gjermanisë

PRISHTINË, 31 MAJ - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në hendboll, Taip Ramadani, ka publikuar listën me emrat e lojtarëve që do të paraqiten në dy ndeshjet e fundit të fazës së dytë kualifikuese për "Euro 2020". Kosova më 12 qershor e pret Poloninë, në ndeshjen që zhvillohet nga ora 20:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë. Ndërsa më 16 qershor nga ora 18:00 Kosova luan me Gjermaninë në Nurnberg. Kosova bën pjesë në Grupin A, ndërsa kualifikimin prej këtij grupi tashmë e ka siguruar Gjermania. Gjermania është e para me 8 pikë, kurse Izraeli është në vend të dytë me 4 pikë. Polonia e Kosova i kanë nga 2 pikë. Në muajin prill Kosova arriti sukses historik, duke fituar në Prishtinë ndaj Izraelit me rezultat 27:24. Suksesi synohet edhe ndaj Polonisë më 12 qershor, ndërsa pritjet janë për numër të madh shikuesish dhe për përkrahje për



Lista e hendbollistëve

Arbër Curri, Kastriot Jupa, Florim Hoxha, Bashkim Gashi, Lendrit Fetahu, Enis Kabashi, Valon Dedaj, Lulzim Shabani, Deniz Terziqi, Armir Agushi, Oltion Beshiri, Egzon Gjuka, Petrit Prekazi, Albin Xhafolli, Luigj Quni, Drilon Tahirukaj, Drenit Tahirukaj, Hasir Berisha, Bujar Ramosaj, Jon Muqolli, Rron Ramadani.

djelmohat tanë. Ramadani ka ftuar 21 lojtarë për këto dy ndeshje, ndërsa numrin më të madh të lojtarëve i kanë Besa Fingas e Kastrioti. Janë ftuar edhe lojtarë nga Prishtina e, po ashtu, të

klubeve të huaja. Ramadanin në punën me kombëtare do ta ndihmojnë trajnerët Erhan Shahini, Veton Hajrizi dhe Enver Tahiraj. Grumbullimi i kombëtares bëhet më 7 qershor në Prishtinë.

SHKURT

Hysaj: Koha ime te Napoli ka përfunduar

Ka muaj që po flitet për një largim të mundshëm të Elseid Hysajt nga Napoli për shkak të mospërshtatjes së lojës së tij me skemat e trajnerit Carlo Ancelotti. Është vetë futbollisti shkodoran që në një rrëfim për "Supersport" i shton më shumë pikëpyetje të ardhmes së tij, duke e pranuar se koha e tij te Napoli ka përfunduar. "Janë shumë skuadra dhe po lexoj si ju. Po pres skuadrën e duhur dhe momentin e duhur. Po mendoj për kombëtaren. Jam gati për aventura të re dhe nuk dua të qëndroj gjithmonë te një skuadër. Dua një shtet të ri dhe njerëz të rinj. Koha ime te Napoli ka mbaruar", ka thënë Hysaj.

Conte, trajner i Interit

Antonio Conte është zyrtarisht trajner i Interit. Ka qenë vetë klubi zikalitër që nëpërmjet një njoftimi në faqen zyrtare ka zyrtarizuar teknikun italian i cili do ta zëvendësojë Luciano Spallettin. Edhe pse Spalletti arriti ta kualifikonte skuadrën në Ligën e Kampionëve për sezonin e ardhshëm, drejtuesit nuk kanë qenë të kënaqur me futbollin e interpretuar nga skuadra, duke i besuar kështu timonin një emri të madh si Antonio Conte. 49-vjeçari kishte disa javë që përflitej për ta marrë drejtimin e Interit, teksa zyrtarizimi ka ardhur mëngjesin e ditës së sotme. Sipas raportimeve të mediave italiane, Conte pritet të përfitojë rreth 10 milionë euro në 2 sezonet e para me Interin. "Një kapitull i ri në jetën time po fillon. Jam shumë i emocionuar. Përmes punës sime unë do të përpiqem ta paguaj të gjithë besimin e presidentit dhe drejtorëve. Kam zgjedhur Interin për shkak të klubit që është, për shkak të projektit serioz që ky klub ka. Do të luftojmë për ta rikthyer Interin atje ku i takon", ka thënë Conte.

City refuzon ofertën e Bayernit për Sanen

Manchester City e ka refuzuar ofertën e Bayern Munchenit për Leroy Sane, raporton "Guardian": Kampionia e Anglisë është e gatshme të heqë dorë nga Sane, por oferta prej 80 milionë eurosh duket se nuk i përmbush synimet e saj. Tash drejtuesve të Bayernit i duhet ta ngritin ofertën ose të heqin dorë nga transferimi i reprezentuesit gjerman. Sane ka luajtur në të kaluarën në Bundesliga për Schalke 04, kurse Bayerni e sheh si zëvendësues ideal për të larguarit Arjen Robben dhe Franck Ribery.

Brescia kërkon ish-lojtarin e Milanit

Futbollisti i njohur japonez Keisuke Honda mund të rikthehet në Itali. 32-vjeçari e mbylli bashkëpunimin me Melbourne Victory dhe është në rikthim të një skuadre të re. Skuadra e Brescias mund të jetë skuadra e radhës e japonezitet. Sipas "Brescia Oggi", drejtuesit e klubit kanë filluar kontaktet e para me ish-lojtarin e Milanit. Përvoja e Hondës vlerësohet shumë nga skuadra italiane që ka si qëllim ta arrijë mbijetesën në Serinë A. Prej gati një viti, krahas futbollit të luajtur, Honda ka qenë gjithashtu trajner i kombëtares së Bolivisë.

Icardi nuk dëshiron të largohet nga Interi

Wanda Nara ka përsëritur se Mauro Icardi planifikon të qëndrojë në Inter për të paktën edhe një sezon tjetër. Spekulumet po rriten disa-ditës për të ardhmen e sulmuesit argjentinas, ndërsa trajneri i ri i Interit, Antonio Conte, dëshiron ta zëvendësojë Icardin me sulmuesin e Manchester Unitedit, Romelu Lukaku ose atë të Romës, Edin Dzeko. Megjithatë, gruaja dhe agentja e Icardit, Wanda, ka folur për mediat dhe ka treguar se sulmuesi dëshiron të mbetet tek Interi. "Ai ka dy vjet të mbetura në kontratën e tij. Synimi i tij është të qëndrojë me Interin për të paktën një sezon tjetër", ka thënë Wanda.



		Autor: GAZMEND MORINA - BENI	PJESË E DHOMËS (sh.shq.)	SËMUNDJE E FËMIJËVE, QË SHFAQET ME SHTRËMBËRIMIN E ESHTRAVE	E BËRA GATI	NDËRTIM ME TË CILIN E RRETHOJMË OBORRIN (shq.)	NEGRI, ZEZAK	TEDI ALVES	EPOKA E RE	E PALËVIZSHME	VITI I RI KINEZ	TOKA E BUKËS	KLUB FUTBOLLI NË ITALI
	MË VJEN GJUMË DUKE NDEJUR, FLE PAK DUKE NDEJUR								SUPER MODELJA KANADEZE JESSICA				
	EMËR I VJETËR PËR DUBROVNIKUN								AKTORJA AM. HATCHER MBËTURINË E NJË KAFSHE PARAHISTORIKE				
	FLUTURUESI I PARË SIPAS MITOLOGJISË							VDEKJEPRURËS ZET, OKSIGJEN					
	HISTORIANI ROMAK LUKRECI (shq.)						ALLAHU, PERËNDIA SHKRONJA TË NJËJTA					ZANORE KAPITULL I FUNDIT I NJË VEPRE LETRARE	
	BABAI					MOTOÇKLISTI I NJOHUR VALENTINO E PËRZIER					EMPOLI, NAPOLI KËNGËTARI VLADI		
	KALORËS MESJETAR							I ZË ME DORË SILLEM LART E POSHTË					ZVOGËLIMI DERI NË PIKËN MË TË ULËT
	THIRRJE E MYEZINIT						GJELBËRIM ZANORE						
EPOKA E RE	FUTBOLLISTI YNË I TALENTUAR NË FOTO (LLAMKOS KOSOVA)	PJESËTARËT E NJË FISI ILIR	GJUMI I THELLË (med.)	ISH SEKRETARI I OKB-së KOFI	RITUAL	SHKRONJA XXVIII & VIII ADRIAN KRASNIQI	AJËR (huaj) PROVIM		DËSHIROJ	INDIAN LAW INSTITUTE REGJISORI MINAROLLI			
	MEKANIZËM QË SHËRBEN PËR TË LEHTËSUAR NGRITJEN E PESHAVE TË RËNDA					MISSISSIPPI TUNDER KINGS ENËT E POSACMË KU MBAHËT HIRI I TË VDEKURIT		TËRËSI E GJALLESAVE NË TOKË VARGJET E PËRPUTHURA					
	SHALQI (shq.)					KUNDREJT ANASE, RRËNJËSE "N" pas dy "A"					GABRIEL IGLESIAS KYÇ		
	LLOJ DEVE E VENDEVE TË AMERIKËS JUGORE (sh.shq.)					MUNDËSIA SULMIMET		PËREMËR VETOR QESËNDISËS				BASHKËT. TER, KA	
	BASKETBOLLISTI TURK OMER				DEGË E MJEKËSISË KITARISTI I FAMSHËM KLEPTON				FUTBOLLISTI SHQIPTAR LILA REGJISORJA SHQIPTARE ELEZI				
	SHKRONJA TË NJËJTA		GJITAR I DËTEVE POLARE	GAZ I PANGJYRË DHE PA ERË MODELJA ÇUNMULAJ			LLOJ HELMI LUFTE NJË PLANET				EDA ZARI DY ZANORE		
	KUMTIM I GJERË ME SHKRIM, QË MBAHËT PARA NJË MBLËDHJEJE					KUJDESTAR (jurid.) RRIPI I LLAMBËS				PREZANTUESE E NJOHUR SHQIPTARE FËMIJË I VOGËL			
	BËRTHAMOR					FELLOWSHIP OF RECONCILIAT. BARAZIM NË SHAH		MODELJA AMERIKANE TAYLOR HUMORISTI BESIM				MOLDE DIREK I ÇATISË	
	BASHKËT.	BIMË QË BËN KOKRRA TË THARA E QË HAHËN TË PJEKURA SMIRA, RESA					CA SHTËT NË EVROPË (pashq.)				TITAN JETËSHK-RIMET		
	SIMBOL I FESË MYSLIMANE, BESIM; BESË				QË ËSHTË PREJ METALI, I METALTË KUMBARË				DAFINË BASHKËT.				FUQI, FORCË (bised.)
	KARBON, AMPËR		PAGJAKËSI POETI VINCA				EDUARD NORTON U ARRATISË NGA BURGU		FLEGËR ZOG ROSE, BIBË ROSE (shq.)				
	LLOJ PAPANALLI			QË SHEH VETËM DOBINË E ÇASTIT OLIVER (shk.)					MARC ANTHONY "TETOVA"			ZANORE GRIMCOVA (bised.)	
EPOKA E RE	NIS TË ZBARDHË DITA ALUMIN					ISH FUTBOLLISTI I NJOHUR BRAZILIAN PRODUKT I ZJARRIT		SFOND SHKRONJASH ISMET HASANI					
	SHTËPI PLEQSH				HAITI, INDIANA BASHKËT.		E BASHKUAR ISLANDA				SOLISTJA QAZIMI ZANORE		
	KUFIZIMI						I KAPËRDIJ		SHTËT (FR.)				



Në bazë të Nenit 8 të Ligjit të Punës (Ligji nr. 03/L-212), UA MPMS nr. 07/2017 dhe Rregullores për Rregullimin e Marrëdhënies së punës 01-2456/17, PK Sh.A. shpall:

KONKURS PUBLIK PËR VENDE PUNE

Titulli i pozitës:

1. Punëtor/e Sportell, grada 5,
2. Postier/e, grada 3,
3. Postier/e me orar jo të plotë të punës 1/2h,
4. Verifikues/e – Regjistruues/e për Marrëdhënie me Dogana në PN/QTP, grada 5
5. Teknik/e në Postën Hibrade, grada 4

Nr. References: 01-1192-1/19

Përshkrimi: PK Sh.A. është duke bërë përpjekje për të zhvilluar biznesin sipas përvojave më moderne të shërbimeve postare dhe komerciale, për t'i arritur standardet ndërkombëtare në ofrimin e shërbimeve postare dhe komerciale. Në këtë aspekt, PK Sh.A. ofron mundësi të barabartë punësimi të profesionistëve që synojnë të jenë pjesë e zhvillimit të biznesit dhe kompetencave të Korporatës, në përphtje me metodat dhe praktikat moderne.

Kohëzgjatja e kontratës: Konform nenit 4 dhe 15 të Rregullores për Rregullimin e Marrëdhënies së Punës për Punonjësit e Postës së Kosovës nr. 01-2456/17, të datës 20.09.2017, kontrata e punës është për kohë të pacaktuar, në të cilën periudhë përfshihet edhe periudha provuese 6 muaj.

Aplikimi: Aplikacionet mund të merren online www.postakosoves.com dhe së bashku me dëshmitë përkatëse të dërgohen nëpërmjet postës në adresën: **Arkiva e PK Sh.A., Ndërtesa Kryesore e PK-së, Rr. 28 Nëntori nr. 4, 10000 - Prishtinë**, deri në afatit e paraparë për aplikim me shenjë "PËR KONKURS", duke e cekur titullin e vendit të punës për të cilin aplikoni.

Aplikacioni dhe të gjitha dëshmitë bashkëngjiten të fotokopjuara, sepse të njëjtat nuk u kthehen aplikantëve. Aplikacionit patjetër duhet t'i bashkëngjitet apo të sillet më vonë tek RNJ-të e PK SH.A., dëshmia (vërtetimi) se aplikanti/ja nuk është nën hetime dhe i/e dënuar.

Afati i fundit për aplikim: 15/06/2019, ora 16:00.

Vendi i punës:

1. Punëtor/e Sporteli – (3 ekzekutues në regjionin e Prishtinës), (1 ekzekutues në regjionin e Gjilanit).

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Ofron shërbime dhe shet të gjitha produktet në sportel, përfshirë edhe implementimin e dimensioneve të parapara dhe raportimin. Është përgjegjës/e për ofrimin dhe shitjen e të gjitha produkteve dhe shërbimeve; Mban përgjegjësi për furnizim të rregullt, ngarkesë me pulla, vlera postare dhe produkte për shitje; Është përgjegjës/e për klasifikimin dhe ruajtjen e dokumentacionit manipulativ financiar në baza ditore, dekadore dhe mujore; Është përgjegjës/e për mirësjellje dhe zbatimin e Kodit të Mirësjelljes; Raporton te Kontrollori/ja i/e Ndërrimit ose Përgjegjësi/ja i/e Postës në baza ditore, dekadore dhe mujore; Kryen edhe punë tjera të nevojshme, të parashtruara nga Kontrollori/ja ose Përgjegjësi/ja i/e Postës; Për punën e vet i raporton Kontrollorit të ZP/Përgjegjësit të Zyrës Postare.

Kualifikimi dhe përvoja e nevojshme:

Punonjësi/punonjësja, për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të Punëtorit/es së Sportelit duhet të ketë kualifikim universitar ose kualifikim të mesëm dhe së paku 1 vit përvojë pune në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të ngjashme si në përshkrimin e vendit të punës.

Vendi i punës:

2. Postier/e – (3 ekzekutues në regjionin e Prishtinës), (3 ekzekutues në regjionin e Prizrenit).

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Pranon dhe shpërndan letër-dërgesat, kolipostat, apo produktet tjera që ofron PK Sh.A., të ndara/ngarkuara nga kartuesi/ja; Është përgjegjës/e për pranimin, dorëzimin e letër-dërgesave, kolipostave në rajonin përkatës; Bën shitjen e produkteve sipas shërbimeve që ofrohen nga PK Sh.A. dhe është përgjegjës/e për arritjen e targeteve të caktuara nga qendra për shitjen e produkteve; Mban përgjegjësi për produktet e pranuar për shitje, tel. USSD, evidencë, klasifikim dhe ruajtje të dokumentacionit manipulativ në baza ditore, dekadore dhe mujore; Zbaton ndryshimet e paraqitura në lidhje me shpërndarjen dhe dorëzimin; Është përgjegjës/e për mirësjellje, zbatimin e Kodit të Mirësjelljes dhe Kodit mbi Trajtimin e Dërgesave Postare; Kryen edhe punë tjera të nevojshme të parashtruara nga Kontrollori i Shpërndarjes/Kartuesi apo Përgjegjësi i Zyrës Postare; Për punën e vet i përgjigjet Kontrollorit të Shpërndarjes/Përgjegjësit të Zyrës Postare.

Kualifikimi dhe përvoja e nevojshme:

Punonjësi/punonjësja, për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të Postierit/es duhet të ketë kualifikim të mesëm, preferohet në drejtimin e shërbimit postar.

Vendi i punës:

3. Postier/e me orar jo të plotë të punës 1/2h - (2 ekzekutues në regjionin e Gjilanit).

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Pranon dhe shpërndan letër-dërgesat, kolipostat, apo produktet tjera që ofron PK Sh.A., të ndara/ngarkuara nga kartuesi/ja; Është përgjegjës/e për pranimin, dorëzimin e letër-dërgesave, kolipostave në rajonin përkatës; Bën shitjen e produkteve sipas shërbimeve që ofrohen nga PK Sh.A. dhe është përgjegjës/e për arritjen e targeteve të caktuara nga qendra për shitjen e produkteve; Mban përgjegjësi për produktet e pranuar për shitje, tel. USSD, evidencë, klasifikim dhe ruajtje të dokumentacionit manipulativ në baza ditore, dekadore dhe mujore; Zbaton ndryshimet e paraqitura në lidhje me shpërndarjen dhe dorëzimin; Është përgjegjës/e për mirësjellje, zbatimin e Kodit të Mirësjelljes dhe Kodit mbi Trajtimin e Dërgesave Postare; Kryen edhe punë tjera të nevojshme të parashtruara nga Kontrollori i Shpërndarjes/Kartuesi apo Përgjegjësi i Zyrës Postare; Për punën e vet i përgjigjet Kontrollorit të Shpërndarjes/Përgjegjësit të Zyrës Postare.

Kualifikimi dhe përvoja e nevojshme:

Punonjësi/punonjësja, për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të Postierit/es duhet të ketë kualifikim të mesëm, preferohet në drejtimin e shërbimit postar.

Vendi i punës:

4. Verifikues/e – Regjistruues/e për Marrëdhënie me Dogana në PN/QTP - (1 ekzekutues).

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Përmbajtja dhe verifikuesit të AP-së dhe verifikuesit të AP-së, bën pranimin dhe përpunimin e të gjitha dërgesave postare të arritura nga administratat postare botërore; Të njëjtat i verifikon dhe i regjistron në listat shoqëruese adekuatë; Në bashkëpunim me zyrtarët e Zyrës së Zhdoganimit, bën hapjen dhe kontrollimin e përmbajtjes së dërgesave, me ç'rast kryhet edhe vlerësimi dhe zhdoganimi i tyre; Pas kontrollimit dhe vlerësimit nga zyrtarët e Zyrës së Zhdoganimit, ngarkon zyrat postare regionale me këto dërgesa, të cilat duhet të zhdoganohen në zyrat postare; Sipas nevojës përpilon edhe fletëthirrjet për klientët, të cilët janë të ftuar nga Dogana që të vijnë në QTP për të tërhequr dërgesat e veta; Bashkëpunon ngushtë me verifikuesit/regjistruuesit e përpunimit të buletineve të verifikimit dhe të tjerët në Sektorin e aviopostës, duke luajtur një rol në përpunimin dhe mangësitë e shfaqura gjatë përpunimit të dërgesave ndërkombëtare; Sipas nevojës dhe perceptimit të eprorit të vet për ndryshime, i njëjti transferohet edhe në sektorët tjerë brenda QTP-së (si në PV, PN, PD etj.); Nuk i lejohet komunikimi me qytetarët dhe dhënia e informatave në lidhje me dërgesat, përveç komunikimit zyrtar përmes KNK-së, kur kërkohen sqarime rreth dërgesave; Respekton komunikimin hierarkik me zyrtarët e PK-së, bazuar në matricën e autorizimeve; Kryen edhe detyra të tjera që lidhen me natyrën e punës së tij/saj, por që nuk bien në kundërshtim me ligjet dhe rregullat në fuqi.

Kualifikimi dhe përvoja e nevojshme:

Për ushtrimin e këtyre detyrave punonjësi/ja duhet të ketë shkollim të mesëm dhe së paku 1 vjet përvojë pune në këtë lëmi; Preferohet njohja e gjuhës angleze; Njohja e mirë e punës me kompjuter; Të ketë aftësi dhe shkathtësi të larta për punën që e kryen dhe punën nën presion.

Vendi i punës:

5. Teknik/e në Postën Hibrade - (1 ekzekutues).

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Pranon detyrat nga menaxheri i Postës Hibrade, kryetekniku i ndërrimit; Bën shtypjen dhe printimin e dërgesave të ndryshme me printerët profesional në Postën Hibrade; Zarfion dërgesat me makinën e zarfimit (enveloper); Mirëmban dhe kujdeset për printerët profesional të Postës Hibrade; Kryen edhe detyra të tjera që lidhen me natyrën e punës së tij/saj, por që nuk bien në kundërshtim me ligjet dhe rregullat në fuqi.

Kualifikimi dhe përvoja e nevojshme:

Shkolla e mesme teknike apo fusha të ngjashme; Minimum 2 vjet përvojë pune në fusha relevante.



U skladu sa članom 8. Zakona o radu (Zakon br. 03 / L-212), Administrativno Uputstvo Ministarstva Rada i Socijalne Zaštite br. 07/2017 i Pravilnik o regulisanju radnih odnosa 01-2456/17, PK A.D. objavljuje:

JAVNI KONKURS ZA RADNO MESTO

Naziv radnog mesta:

1. Radnik /ca Šaltera, (rang 5)
2. Poštar/ka, (rang 3)
3. Poštar/ka ½ (rang 3 ½)
4. Verifikator/ka – Registrator/ka za Carinske Odnose (MP/PTC) (rang 5)
5. Tehničar/ka u Hibradnoj Pošti (rang 4)

Referentni Br. 01- 1192-1/19

Opis:

PK A.D. nastoji da razvije poslovanje u skladu sa najsvremenijim iskustvima poštanskih i komercijalnih usluga, kako bi zadovoljio međunarodne standarde u

skladu sa savremenim metodama i praksama.

Trajanje Ugovora: U skladu sa članovima 4 i 15 Pravilnika o regulisanju radnih odnosa za zaposlene u Pošti Kosova Br. 01-2456/17 od 20.09.2017. godine, ugovor o radi je za neodređeno vreme, koji uključuje probni period od 6 meseci.

Aplikacija: Aplikacije možete preuzeti na internetu www.postakosoves.com i zajedno sa relevantnim dokazima poslatim poštom na adresu: **Arkiva PK A.D. "Glavna zgrada PK, Ul. 28. Novembar Br. 4, 10000 – Priština"**, do roka za prijavu obeležen naznakom radnog mesta za koji se prijavljujete.

Aplikacije i svi dokazi priložiti fotokopirane

Aplikacije se moraju priložiti ili kasnije dostaviti LJR PK A.D., dokaz (potvrda) da podnosioc prijave nije pod istragom ili osuđen.

Zadnji rok za prijavu: 15.06.2019, vreme 16:00 časova.

Radno mesto

1. Radnik/ca Šaltera, (3 izvršioc u regionu Pristina), (1 izvršioc u regionu Gnjilane)

Glavne dužnosti i odgovornosti:

i realizaciju predviđenih dimenzija i izveštavanja; Odgovoran je za pružanje i prodaju svih proizvoda i usluga; Odgovoran je za redovno snabdevanje poštanskih marka, poštanskih vrednosti i proizvode za prodaju; Odgovoran je za klasifikaciju i održavanje finansijskih manipulativnih dokumenata svakodneвно, dekadentno i mesečno; Odgovoran je za učtivost i primenu Kodeksa ponašanja; Izveštava svakodneвно, dekadentno i mesečno Kontroloru smene ili Odgovornog lica pošte. Obavlja i druge neophodne poslove postavljene od Kontrolora, ili Odgovornog lica pošte; Za svoj rad, izveštava Kontroloru / Odgovornom licu pošte.

Obrazovanje, veštine i ostalo:

Zaposlenik/zaposlenica za obavljanje dužnosti i odgovornosti Radnik Šaltera treba imati univerzitetsku kvalifikaciju ili kvalifikaciju srednje škole i radno iskustvo najmanje 1 godinu u vršenju sličnih dužnosti i odgovornosti kao u opisu radnog mesta.

Radno mesto

2. Poštar/ka, (3 izvršioc u regionu Pristina), (3 izvršioc u regionu Prizren)

Glavne dužnosti i odgovornosti:

Primi i isporučuje pismonosne pošiljke, paket ili druge proizvode koje pruža PK A.D. odvojene/zadužene od Kartista; Odgovoran je za prijem, predaju pismonosnih pošiljka, paketa u odgovarajućoj regiji; Prodaje proizvode prema uslugama koje pruža PK A.D. i odgovoran je za postizanje određenih ciljeva iz centra za prodaju proizvoda; Odgovoran za proizvode primljene za prodaju, tel., USSD, evidenciju, klasifikaciju i očuvanje manipulativne dokumentacije svakodneвно, dekadentno i mesečno; Primenjuje promene predstavljene u pogledu dostave i uručjenja; Odgovoran za učtivost, sprovođenje Kodeksa ponašanja i Kodeksa za rukovanje poštanskim pošiljkama; Obavlja i druge neophodne poslove postavljene od Kontrolora Distribucije/Kartista ili Odgovornog lica pošte; Za svoj rad, izveštava Kontroloru Distribucije/Odgovornog lica pošte.

Radno mesto

3. Poštar/ka ½, (2 izvršioc u regionu Gnjilane)

Glavne dužnosti i odgovornosti:

Primi i isporučuje pismonosne pošiljke, paket ili druge proizvode koje pruža PK A.D. odvojene/zadužene od Kartista; Odgovoran je za prijem, predaju pismonosnih pošiljka, paketa u odgovarajućoj regiji; Prodaje proizvode prema uslugama koje pruža PK A.D. i odgovoran je za postizanje određenih ciljeva iz centra za prodaju proizvoda; Odgovoran za proizvode primljene za prodaju, tel., USSD, evidenciju, klasifikaciju i očuvanje manipulativne dokumentacije svakodneвно, dekadentno i mesečno; Primenjuje promene predstavljene u pogledu dostave i uručjenja; Odgovoran za učtivost, sprovođenje Kodeksa ponašanja i Kodeksa za rukovanje poštanskim pošiljkama; Obavlja i druge neophodne poslove postavljene od Kontrolora Distribucije/Kartista ili Odgovornog lica pošte; Za svoj rad, izveštava Kontroloru Distribucije/Odgovornog lica pošte.

Radno mesto

4. Pozicija: Verifikator/ka – Registrator/ka za Carinske Odnose (MP/PTC) (1 izvršioc)

Glavne dužnosti i odgovornosti:

Kroz nadzornika Poštanske Administracije (PA) i verifikatora PA, čini prihvatanje i obradu svih poštanskih pošiljki koje su postigle svetskih poštanskih administracija; Proverava i registruje iste u odgovarajućim pratećim listama; U saradnji sa Službenicima Kancelarije za Carinjenje, otvara i kontroliše sadržaj pošiljke, pri čemu se vrši njihovo procenjanje i carinjenje; Nakon provere i procenjanja od strane službenika Kancelarije za Carinjenje, zadužuje regionalne pošte sa ovim pošiljkama, koje moraju biti ocarinjene u poštanskim kancelarijama; Po potrebi, on takode sastavlja pozivnice korisnike koje carine pozivaju da dođu u PTC da povuku svoje pošiljke; Blisko saraduje sa verifikatorima / registratorima obrade biltena i ostalim u Sektoru Avio-pošte, davanjem detaljima o nepravilnostima i nedostacima otkrivenim tokom obrade međunarodnih pošiljki; U zavisnosti od potreba i percepcije svog supervizora za promenu, isti može da se premosti i na druge sektore unutar PTC (kao što su DS, MS, DP itd.); Nije dozvoljeno da komunicira sa građanima niti pružanje informacije o pošiljkama, osim službene komunikacije preko BoK (Brige o Korisnicima), kada su potrebna objašnjenja o isporukama; Poštuje hijerarhijsku komunikaciju sa zvaničnicima PK, na osnovu matrice ovlašćenja; Obavlja druge poslove vezane za prirodu svog rada, ali koje nisu u suprotnosti sa važećim zakonima i propisima.

Potrebna kvalifikacija i iskustvo:

Za obavljanje ovih dužnosti zaposlenik/ca mora imati srednje obrazovanje i najmanje 1 godinu radnog iskustva u ovoj oblasti;

Poznavanje engleskog jezika je poželjno;

Dobro poznavanje računarskog rada;

Da poseduju visoke veštine i sposobnost za svoj posao koji obavlja i da može raditi pod pritiskom.

Radno mesto

5. Pozicija: Tehničar/ka u Hibradnoj Pošti (1 izvršioc)

Glavne dužnosti i odgovornosti:

Prima zadatke od Menadžera Hibradne Pošte i Glavnog Tehničara smene;

Štampa razne pošiljke sa profesionalnim štampačima u Hibradnoj Pošti;

Čini kovertiranje (uvijanje) pošiljke sa mašinom za kovertiranje (enveloper);

Održava i brine o profesionalnim štampačima Hibradne Pošte;

Obavlja druge poslove vezane za prirodu svog rada, ali koje nisu u suprotnosti sa važećim zakonima i propisima.

Potrebna kvalifikacija i iskustvo:

Tehnička srednja škola ili slične oblasti;

Minimum 2 godine radnog iskustva u relevantnim oblastima.

Nesër me 2. 6. 2019 bëhen 11 vjet pa babain dhe gjyshin tonë



Ilaz (Vesel) Krasniqi

(20. 9. 1943 - 2. 6. 2008)

Edhe pse nuk je në mesin tonë, Ti gjithmonë do të mbetesh në zemrat tona. Mungon në çdo ngjarje që ne e përjetojmë, mungon por nuk harrohesh asnjëherë.

I përjetshëm mbetet kujtimi për Ty.

Të kujtojnë me mall: Djemt, vajzat, rejat, nipat dhe mbesat nga Tërpeza

Ftese për takim me qytetarë
Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal
(PZHK) 2019-2027 Profili Komunal
Mitrovicë Jugore

06.06.2019

(ora: 14:00)

Salla e Kuvendit Komunal, Mitrovicë



INCLUSIVE DEVELOPMENT PROGRAMME
PROGRAMI PËR ZHVILLIM GJITHËPËRFSHIRËS
PROGRAM SVEOBUHVATNOG RAZVOJA

